

DHUNA NË FAMILJE NË FOKUSIN E MEDIAS

Udhëzues



Aleanca Gjinore për Zhvillim

Botimi i kësaj guide është mbështetur financiarisht nga **Zyra e Marrëdhënieve me Publikun e Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë**, në kuadrin e projektit **“Mjete praktike për raportimin në media të dhunës në familje”**. Opinione, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Autorët: Mark Marku
Elda Berisha
Eglantina Gjermani
Irena Shtraza

© 2008, Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për Qendrën “Aleanca Gjimore për Zhvillim”, Tiranë, Shqipëri.

Adresa:
Aleanca Gjimore për Zhvillim
P.O. Box 2418, Tiranë, Albania
Tel. & Fax: (+355) 4 2255 514/ 5
E-mail: qdi@gadc-al.org
Në internet: www.gadc-al.org

Faqosja & Kopertina: Elvira Çiraku
Shtëpia botuese: **Mediaprint**
ISBN:

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	5
Pse është e rëndësishme kjo guidë?	7
1. DHUNA NE FAMILJE -NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM ..	13
a. Çfarë është dhuna në familje	13
b. Format e dhunës në familje	14
i. Dhuna ndaj gruas	17
ii. Dhuna ndaj fëmijëve	19
iii. Dhuna ndaj burrave	19
iv. Dhuna ndaj të moshuarve	20
c. Dhuna në familje dhe disa faktorë të tjerë kontribues	21
d. Pasojat e dhunës në familje	23
e. Kostot social ekonomike të dhunës në familje	25
f. Mite rreth dhunës ndaj grave	26
g. Frekuenca/Statistika të dhunës në familje në Shqipëri	27
2. KUADRI LIGJOR DHE I POLITIKAVE NË SHQIPËRI	31
a. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë	31
b. Kodi i Familjes	31
c. Ligji ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’ ...	31
d. Zbatimi i ligjit ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’	33
e. Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje	36
f. Ligji për ‘Barazinë Gjinore në Shqipëri’	39
3. RAPORTIMI I DHUNËS NË FAMILJE NË MEDIA	41
a. Raportimi i dhunës në familje në mediat shqiptare	41
b. Gabimet që bëhen më shpesh në raportimin e dhunës në familje në mediat shqiptare	44
c. Ndikimi i mediave	49

4. UDHËZIME MBI RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE	55
a. Argumente mbi rëndësinë e një perspektive gjinore në pozicionimin e medias	55
b. Për një etikë të raportimit të dhunës në familje - Imazhe të dhunës në artikullin ose reportazhin tuaj	57
c. Përdorni burime të besueshme të informacionit për artikullin ose reportazhin tuaj.....	60
d. Si të ndërtohet një mesazh për raportimin e dhunës në familje... ..	62
ANEKS	68
a. Mekanizmat ndërkombëtare kundër dhunës në familje ..	68
b. Përkufizime	71
c. Qendra/Institucione që ofrojnë asistencë lidhur me dhunën në familje	73
BIBLIOGRAFIA	77
BURIME NGA INTERNETI	80

Hyrje

Dhuna në familje haset në shumë shoqëri njerëzore, pavarësisht nga niveli i zhvillimit ekonomik e social të tyre. Ajo është një fenomen global dhe prek të gjitha shtresat e popullsisë - të rinj dhe të moshuar, të arsimuar apo analfabetë, të martuar apo beqarë, prek çdo kombësi, klasë, racë apo grup etnik. Ajo përfshin dhunimin e të drejtave qytetare, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale të njeriut. Të dhënat alarmante nga e gjithë bota lidhur me shkallën e dhunës në familje konfirmojnë faktin se dhuna në familje është një problem ndërkombëtar. Në Konferencën e Katërt të Kombeve të Bashkuara në Pekin (1995) është theksuar se dhuna ndaj gruas përbën një dhunim të të drejtave njerëzore dhe përbën një pengesë në arritjen e barazisë, zhvillimit dhe paqes në shoqëri.

Nuk e ekzagjerojmë po të themi se dhuna e krimi në familje këto vitet e fundit, ka “triumfuar” mbi llojet e tjera të krimeve. Për fat të keq, sot dhuna është shumë pranë nesh, pranë shtëpive tona, brenda në familje.

Dhuna jeton dhe na shoqëron si pa u ndjerë, e pakontrolluar, gati si një epidemi. Njerëzit që përjetojnë dhunën, si viktimat ose dëshmitarë, mësojnë (ndërmjet të tjerave) të kenë frikë, ta evitojnë dhunën ose të bëhen njëlloj të dhunshëm si dhunuesi. Shpesh dhuna kthehet në tragjedi, e në rastet më “fatlume” ajo shoqëron si hije jetën e njeriut¹.

¹ Bregu, M., Gjermani, E., Korrik 2003. ‘Dhuna ndryshon atë që prek’, Gazeta ‘Koha Jonë’.

Gazetat dhe media në përgjithësi raportojnë thujtë çdo ditë rreth këtij fenomeni të vështirë për t'u trajtuar dhe akoma më të vështirë për t'u raportuar, pasi të kuptosh dinamikat e dhunës shumë shpesh nuk është e lehtë. Duke parë se sa të shpeshta janë rastet e dhunës në familje në shoqërinë shqiptare, na u duk i nevojshëm përpilimi i këtij udhëzuesi orientues për median. Ky udhëzues është menduar për të asistuar gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias, në raportimin sa më të saktë të dhunës në familje dhe dhunës në përgjithësi. Shpresojmë që materiali që do gjeni në këto faqe, do të qartësojë idetë tuaja dhe do t'ju lehtësojë punën në lidhje me raportimin e saj.

Raportimi i ndjeshëm i këtij argumenti kaq delikat nga mediat e shkruara apo elektronike, mund të sjellë ndryshime shumë domethënëse në ndërgjegjësimin e komunitetit shqiptar rreth dhunës në familje, shkaqeve që e sjellin atë dhe pasojave tragjike të saj. Duke e vlerësuar rolin e medias si “formues” dhe jo vetëm “informues”, mendojmë që roli dhe kontributi që jep edhe mund të vazhdojë të japë media në parandalimin e dhunës në familje, është jashtëzakonisht i rëndësishëm edhe i pazëvendësueshëm.

Lexim të mbarë,

Aleanca Gjinore për Zhvillim

Pse është i rëndësishëm ky udhëzues?

Roli i medias në shoqërinë e sotme dinamike është provuar të jetë mjaft ndikues, jo thjesht si një informues për ngjarjet, por më së shumti si drejtues i fokusit, opinion-formues dhe madje edukues i prirjeve dhe qëndrimeve publike të kohës. (Grifin, 2005: 403). Dhe kjo është e kuptueshme, po të kemi parasysh faktin se mediat arrijnë një audiencë të gjerë në një kohë relativisht të shkurtër, kanë zë të fuqishëm dhe mund të trajtojnë me gjerësi tema të caktuara (veçanërisht kur flasim për mediane e shkruar), veçori që lidhen ngushtë dhe me prirjen e audiencës së sotme për të shpenzuar kohë të konsiderueshme me median, siç pranon Woods, *“Media depërton në gjithë jetën tonë”* (2005: 232).

Sigurimi i një raportimi që do të ndërthurte në harmoni këtë epërsi të medias në çështje për të cilat shoqëria ka ndjeshmëri, (ndërsa pjesë të caktuara të kësaj shoqërie ndërmarrin dhe rol aktiv), siç është rasti i raportimit të dhunës në familje, do të ishte jo vetëm pjesë e një portofoli profesional të gazetarit, por në rastin më të mirë dhe një detyrë qytetare e përmbushur me përkushtim. Duke bërë zgjedhjen e duhur për llojin e historisë që do të bëhet subjekt i raportimit, për burime të besueshme dhe të paanshme, zgjedhjen e kujdesshme të fjalëve dhe një gjuhë kumbuese, përzgjedhjen e të intervistuarve që japin një perspektivë të tyren (qoftë përvojë personale), zgjedhjen e imazheve që flasin vetë dhe përcjellin efekte të ndjeshme, etj, media ka fuqinë të tejojë një mesazh shumë të fuqishëm. *Ky mesazh duke lënë gjurmë, rrit në përgjithësi ndërgjegjësimin e shoqërisë për faktin se dhuna është një dukuri që vetëm*

dëmton dhe nuk i bën mirë askujt, por nga ana tjetër edhe informon se ndaj saj ka tanimë edhe mjete ligjore që i japin mbështetje me forcën e ligjit të dëmtuarve nga kjo dukuri. Së fundmi, media ka rolin e jashtëzakonshëm, që duke formësuar opinione, të ndikojë për të ndërtuar qëndrime e për të sjellë impakt në mentalitetin e shoqërisë shqiptare ndaj trajtimit si tabu të dhunës.

Ky udhëzues synon të ndërtojë themelet e një komunikimi ndryshe në lidhje me raportimin e dhunës familjare në media duke ndërmarrë hapa në përgjigje të pyetjes *‘Si të komunikojmë mesazhin ndryshe?’*. Komunikimi i mesazhit ndryshe lidhet me përmbajtjen e mesazhit – çfarë duam të themi, me pozicionimin ndaj faktit që raportohet, me formën e mesazhit, përdorimin e gjuhës si mjet për ndërtimin e mesazhit dhe transmetimin e qëllimit. Ai merr parasysh gjithashtu kontekstin dhe audiencën, duke u prirur nga besimi se vetëm nëse dhe audiencia bëhet pjesë aktive e procesit, mund të arrihet ndryshimi në perceptim dhe më tej në mentalitet.

Megjithëse media mund të mos jetë përgjegjëse për veprimet, qëndrimet ose sjelljet e individëve, ajo është pa diskutim e plotfuqishme në formimin e opinionit publik, theksimin e çështjeve apo perspektivave që mund të jenë objekt i debateve publike. Media gjithashtu mund të jetë një mjet shumë i fuqishëm për promovimin e barazisë gjinore në shoqëri.

Këshilli i Europës në Rekomandimet për Barazinë midis Burrave dhe Grave në Media (nr. R84-17) nënvizon se *“media luan një rol të rëndësishëm në formimin e qëndrimeve dhe vlerave sociale dhe gjithashtu ofron një potencial shumë të madh si instrument të ndryshimeve sociale”*. Kombet e Bashkuara që prej vitit 1995 (me Platformën e Pekinit), kanë identifikuar *‘median dhe përkatësinë gjinore’* si një nga çështjet më kritike që lidhen drejtpërdrejt me barazinë gjinore.

“Ajo që ne dëgjojmë dhe shohim në media është një proces përzgjedhjeje. Kjo përzgjedhje reflekton prioritete dhe pikëpamje të ndryshme tonat kundrejt botës që na rrethon. Zgjedhja jonë dhe të gjitha mënyrat se si prezantohet ajo në media, riprodhojnë supozime të caktuara rreth rolit dhe statusit të grave në shoqëri.”

Prandaj është shumë e rëndësishme që të jemi të ndërgjegjshëm se:

- Ato që shohim në ekranet tona janë portretizime sipas përkatësisë gjinore.
- Kur përzgjedhim se çfarë të shikojmë/dëgjojmë, ne bazohemi te përmbajtja.
- Duhet të ndërgjegjësohemi rreth tendencave dhe faktorëve që formojnë përmbajtjen në media.

Imazhi i vajzave dhe grave në media ndikon në rolin dhe statusin që ato kanë në shoqëri dhe ky imazh ndryshon mënyrën sesi ato perceptohen nga të tjerët. Fatkeqësisht ky imazh është më shpesh negativ sesa pozitiv, duke promovuar kështu stereotipe të paramenduara dhe vënien në jetë të paragjyqimeve sociale dhe qëndrimeve prapanike që janë të rrënjosura thellë.

Sipas Kombeve të Bashkuara, projektimit të vazhdueshëm të imazheve ‘të vjetra’ të vajzave dhe grave në sistemin mediatik global, i ka ardhur koha të eliminohet.

Në media nuk ka një mesazh universal. Mënyra se si merret, transmetohet dhe perceptohet nga individët varet shumë nga niveli i zhvillimit, përvoja, njohuritë, këndvështrimet, etj.

Normat dhe vlerat, strukturat institucionale, preferencat e audiencës, rregullat e ekonomisë së tregut, ndikojnë në produktin final të medias.

Gjatë dy 10-vjeçarëve të fundit:

- Natyra dhe frekuenca e dhunës ndaj grave në shoqëri u diskutua si çështje e rëndësishme në axhendën ndërkombëtare në vitet '90-të.
- Në 1993, Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave ishte i pari dokument ndërkombëtar i të drejtave të njeriut që trajtoi këtë çështje.
- Në Mars 1994, Komisioni i të Drejtave të Njeriut në Kombet e Bashkuara caktoi një raportues për Dhunën ndaj Gruas.
- *Platforma e Pekinit (1995)* e përfshiu “Dhunën ndaj gruas” si një nga 12 çështjet kritike për t’u adresuar nga qeveritë dhe aktorët e tjerë. Gjithashtu, tërhoqi vëmendjen e medias lidhur me “produktet mediatike të dhunshme ose pornografike...që ndikojnë në mënyrë negative gratë dhe pjesëmarrjen e tyre në shoqëri”.
- Në vitet pas Platformës për Veprim të Pekinit diskutimi mes lidhjeve të medias dhe dhunës u fokusua në dy çështje kryesore:
 - Shkalla në të cilën aspektet negative dhe stereotipizuese të imazheve të grave në media mund të kontribuojnë në dhunën gjinore në shoqëri;
 - Si dhe mbulimi mediatik i incidenteve të dhunës ndaj grave.
- *Në nenin 5 të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) thuhet se:*

Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme me synimin që:

- a) Të ndryshojnë skemat dhe modelet e sjelljes shoqërore dhe kulturore të burrit dhe të gruas, në mënyrë që të arrijnë të zhdukin paragjykimet dhe praktikat zakonore, ose të çdo lloji tjetër, që mbështeten në idenë e inferioritetit ose të epërsisë së njërit apo të tjetrit seks, apo në rolin stereotip të burrit dhe të gruas;
- b) Të sigurojnë që edukimi i familjes të përfshijë kuptimin

e duhur të amësisë si një funksion shoqëror dhe njohjen e përgjegjësisë së përbashkët të burrit dhe të gruas në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre, duke bërë të qartë se interesi i fëmijëve është kushti parësor në të gjitha rastet.

- Në Rekomandimet mbi Barazinë mes Grave dhe Burrave në Media të Këshillit të Europës theksohet se: “media luan një rol të rëndësishëm në formimin e qëndrimeve dhe vlerave të individëve si dhe shërben si një instrument i dobishëm për ndryshimet sociale”.
- Në vitin 1999, në një video-konferencë globale organizuar nga UNIFEM në bashkëpunim me agjenci të tjera të Kombeve të Bashkuara, u diskutua **roli i medias** si mjet për të rritur efektivitetin e agjencive të tjera për minimizimin e dhunës ndaj grave dhe si një fokus specifik për avokaci për eliminimin e dhunës. Në këtë konferencë u theksua fakti se “Media ka një rol kryesor në stimulimin e debatit publik, ekspozimin e frekuencës dhe egërsinë e dhunës ndaj gruas dhe sigurimit të një forumi për eksplorimin e strategjive në fusha të tjera”.
- Standartet e BE-së lidhur me trajtimin e barabartë të grave dhe burrave janë pjesë e legjislacionit, të siguruara përmes disa neneve të Traktatit të Amsterdimit në vitin 1997.
 - Neni 2 i këtij Traktati deklaron barazinë mes grave dhe burrave si një nga përgjegjësitë kryesore të Shteteve Palë të Komunitetit Europian.
 - Neni 3 (pika 2) nënvizon se ‘Në të gjitha aktivitetet që lidhen me këtë nen, shtetet palë të BE duhet të synojnë eliminimin e pabarazive dhe të promovojnë barazinë mes grave dhe burrave.
- Ndërsa në Platformën për Arritjen e Barazisë Gjinore (Roadmap to Gender Equality 2006-2010) të Komunitetit Europian theksohen gjashtë fusha prioritare për vitet 2006-2010, duke përfshirë:
 - pavarësinë ekonomike si për gratë edhe për burrat;

- pajtimin e jetës personale dhe profesionale;
- përfaqësim të barabartë mes grave dhe burrave në vendimmarrje;
- minimizimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore;
- eliminimin e stereotipeve gjinore; si dhe
- promovimin e barazisë gjinore në politikat e zhvillimit dhe në politikat e jashtme.

Shprehimisht në këtë Platformë theksohet se: *“Vendet që duan t’i bashkohen Bashkimit European duhet të kenë parim bazë arritjen e barazisë gjinore mes grave dhe burrave... Monitorimi dhe përafrimi i legjislacionit të barazisë gjinore, si edhe zbatimi i tij, do të jetë një prioritet i BE në proceset e zgjerimit të tij.”*

“Të drejtat njerëzore të grave dhe vajzave janë një pjesë e patjetërsueshme, integrale dhe e pandashme e të drejtave universale.

Deklarata e Vienës & Programi për Aksion, 1993

Duhet të kuptojmë se jo të gjitha gratë e shikojnë botën ndryshe nga meshkujt. Shumë gra dhe burra ndajnë të njëjtat perspektiva kulturore, pasi janë rritur nga të njëjtët mekanizma dhe institucione sociale. **Sfida në këtë rast qëndron në ndryshimin e perceptimeve të të dyja palëve, burrave dhe grave, rreth rëndësisë së rivlerësimit të rolit dhe problematikave të gruas në shoqëri.** (Noeleen Heyzer)²

Të kuptuarit e dinamikave të dhunës në familje, si dhe diskutimi me ekspertët e dhunës në familje, për ta vendosur këtë krim në kontekstin shoqëror, do të shërbente si një hap përpara në ndërgjegjësimin e mediave dhe mbarë publikut.

² Training Manual, 1998 *‘Whose Perspective – a Guide to Tender Sensitive Analysis of the Media’*, Women’s Media Watch Jamaica; fq 29.

1. DHUNA NE FAMILJE – NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

A. Çfarë është Dhuna në Familje

Duke u bazuar në vlerat universale të familjes, Organizata e Kombeve të Bashkuara e përkufizon dhunën në familje *si një akt që rezulton, ose ka shumë mundësi të rezultojë në dëmtim fizik, seksual ose mendor duke përfshirë kërcënime ose akte të ngjashme, shtrëngimet ose heqjen arbitrare të lirisë*. Dhuna në familje është një nga format e krimeve më pak të raportuara dhe zakonisht konsiderohet si një çështje private, si rrjedhojë nuk dihen me saktësi përmasat dhe frekuenca e fenomenit. Megjithatë studimet e kryera tregojnë se dhuna në familje, sidomos ajo ndaj grave dhe vajzave, është rritur gjatë periudhës së tranzicionit. Vështirësia e grumbullimit të informacionit mbi dhunën në familje vjen dhe si pasojë e gjendjes ekonomike të viktimave, të cilat në shumë prej rasteve janë të varfra (sidomos në vendin tonë) dhe janë individët të cilët kanë aksesin më të kufizuar ndaj informacionit për të drejtat e tyre, shërbimeve sociale, ndihmës juridike apo dhe vëmendjes së medias.³

Në Konferencën e Katërt Botërore të Pekinit e mbajtur në shtator 1995, dhuna në familje u përkufizua si *“një problem mbarëbotëror dhe që duhet trajtuar si i tillë.”* Po në këtë konferencë është theksuar se *‘dhuna ndaj gruas përbën dhunim të të drejtave njerëzore, si dhe një pengesë në arritjen e barazisë, zhvillimit dhe paqes’*.

³ Aleanca Gjimore për Zhvillim, 2006. *‘Dhuna në Familje, Paraqitje e situatës aktuale në Shqipëri’*.

Në Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas është dhënë një përkufizim tjetër për dhunën në familje si *“një mekanizëm kryesor nga i cili gratë janë detyruar të qëndrojnë në një pozicion inferior, krahasuar me burrat”*.⁴

Në Deklaratën “Kundër Dhunës ndaj Gruas”, bërë nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, është dhënë përkufizimi i parë zyrtar, në të cilin thuhet se *“dhunë ndaj gruas në familje do të konsiderohet çdo akt i bazuar në përkatësinë gjinore që rezulton në, ose mund të rezultojë në: lëndime fizike, seksuale apo psikologjike, ose që shkakton vuajtje tek gratë, duke përfshirë edhe kërcënime për akte të tilla, detyrimin apo privimin arbitrar të lirisë, pavarësisht nëse këto ndodhin në publik apo në jetën private”*.⁵

B. Format e dhunës në familje

Ekzistojnë disa forma të dhunës, ndër të cilat më poshtë janë renditur ato më të përhapurat. S’duhet harruar që shpesh këto forma të ndryshme të dhunës në familje i gjejmë të gërshetuara me njëra tjetrën.

- **Dhuna Fizike** e cila përfshin: shtyrje; goditje; gërvishtje; mbylljen në shtëpi; goditje me objekte të forta; kërcënim me thikë ose me armë tjetër; refuzim për ta ndihmuar gruan kur është shtatzënë ose e sëmurë; tentativë për vrasje deri në formën më të rëndë; vrasjen. Forma të dhunës fizike janë edhe përpjekjet për të kontrolluar e monitoruar lëvizjet e gruas. Gratë që dyshohet se nuk janë “të rregullta” dhe “korrekte” në marrëdhëniet bashkëshortore shpesh bëhen viktimat e formave ekstreme të dhunës fizike. Ato jo vetëm janë rrahur, lidhur me litar, por ju janë shuar cigare në trup,

⁴ Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, 48/104, 1993

⁵ Raport i OKB mbi Dhunën ndaj Grave, 1993.

janë tërhequr zvarrë, ju janë thyer eshtrat ose janë lënë natën jashtë derës së shtëpisë të vetme dhe të dhunuara.

Dhuna fizike në përgjithësi ushtrohet duke filluar nga format më të lehta për të arritur deri tek ato më ekstremet. Dhunuesit janë tepër testues dhe të kujdesshëm me rritjen e nivelit të dhunës. Përgjithësisht kjo formë e dhunës takohet pas vitit të parë të martesës, gjatë shtatzënisë, për t'u përshkallëzuar pas lindjes së fëmijës së parë e për të vazhduar gjatë gjithë jetës bashkëshortore nëse gruaja nuk e kundërshton atë ose nuk gjen një mënyrë për të shpëtuar prej saj. Të dhënat tregojnë se një numër i konsiderueshëm grash, viktimat të dhunës në familje, e kanë përjetuar atë që në familjen e origjinës. Viktimat tregojnë se edhe nënat e tyre janë abuzuar njësoj nga bashkëshortët dhe kurrë nuk e kanë kundërshtuar atë. Çfarë është edhe më e dhimbshme, ndonëse këto nëna janë lutur për një jetë më të mirë të vajzave të tyre, prapëseprapë ju kanë dhënë atyre mesazhin se “burrat duhen duruar”.

- **Dhuna Psikologjike/Emocionale** përfshin: talljet; kërcënimet; ndjekjen nga pas; mohimin e hapësirës për të marrë vendime; ndalimin për dalë me shoqërinë apo dhe për të dalë vetëm; kritikën e vazhdueshme ndaj kulturës apo zakoneve; sharjet ndaj viktimës në shtëpi dhe në publik; ngarkimin me faj të viktimës për çdo gjë që shkon keq; kontrollin ndaj veshjes dhe gardërobës; etj. *Dhuna Shpirtërore* gjithashtu përfshihet në dhunën psikologjike dhe konsiston në ndalimin e shprehjes së besimit fetar ose normave kulturore, traditave dhe besimit shpirtëror.
- **Dhuna Seksuale** përfshin: marrëdhënie seksuale me forcë; trajtimin e partneres si objekt seksual; detyrimin për të bërë seks pa dëshirën e partneres; detyrimin për të realizuar seks në forma të padëshiruara dhe të papranueshme për partneren; këmbënguljen për të prekur e për të bërë gjithçka që dëshiron partneri; detyrimin për të bërë seks me një partner tjetër në sy ose jo të vetë bashkëshortit/partnerit; realizimi i marrëdhënieve seksuale me një partnere tjetër në sy të

bashkëshortes; deklarimi për një lidhje jashtëmartesore detyrimi për të kryer marrëdhënie seksuale pas ushtrimit të dhunës fizike; detyrimi për të bërë prostitucion; detyrimi për të bërë striptizë; etj. Mbështetur nga të dhënat e qendrave të këshillimit kjo është forma e tretë e dhunës që deklarohet nga gratë viktimat. Në këtë rast duhet nënvizuar fakti se ndonëse një dhunë e pastër seksuale mund të jetë e treta për sa i përket frekuencës së saj, ajo është gjithnjë e implikuar dhe e gërshetuar me format e tjera të dhunës si dhuna emocionale dhe ajo fizike.

- **Dhuna Ekonomike** përfshin: kontrollin e parave në mënyrë që të mos i lihet viktimës mundësia për të marrë vendime për çështje ekonomike; dhënia e një vlefte të vogël parash që nuk është e mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve ekonomike; refuzimi për të mbuluar shpenzimet e fëmijëve; forcimi për të vjedhur ose shitur gjërat e vlefshme; mohimi i mundësisë që pasuria të jetë edhe në emër të partneres/bashkëshortes; etj.

Dhuna në familje nuk ka të bëjë vetëm me dhunën ndaj njeriut prej bashkëshortëve, e cila në më të shumtën e rasteve është e drejtuar ndaj gruas. Në *konceptin e dhunës në familje sot përfshihen dhe nënkuptohen dhuna ndaj grave, dhuna e prindërve ndaj fëmijëve, dhuna midis fëmijëve, dhuna e fëmijëve, kryesisht e adoleshentëve ndaj prindërve, si dhe dhuna ndaj të moshuarve*. Dhuna ndaj grave dhe dhuna ndaj fëmijëve ka tërhequr historikisht vëmendjen e studiuesve dhe të specialistëve të fushës. Dhuna ndërmjet fëmijëve, dhuna e fëmijëve ndaj prindërve si dhe dhuna ndaj të moshuarve kanë marrë më pak ose aspak vëmendje nga studiuesit dhe specialistët.

Kjo nuk do të thotë se këto forma të dhunës në familje janë më pak shqetësuese për publikun e gjerë dhe se ky i fundit nuk ka interes të informohet për to. Tashmë është një realitet se dhuna në familje, ndonëse një problem i prezantuar vetëm në mesin e shekullit të kaluar (vitet 1960), ka kaluar nëpër një proces të

gjatë përkufizimi,

përcaktimi dhe identifikimi. Pavarësisht formave të ndryshme të shfaqjes së dhunës në familje, aktualisht vendin dhe vëmendjen kryesore e ka tërhequr dhuna ndaj gruas dhe dhuna ndaj fëmijëve në familje.

i) DHUNA NDAJ GRUAS

Është keqtrajtimi i gruas nga partneri i saj ose pjesëtarë të tjerë të familjes. Gratë dhe vajzat rezultojnë të jenë viktimat më të shpeshta të dhunës në familje. Interesant është fakti se vajzat përjetojnë dhunë që në moshat më të hershme. Nuk është martesë që shoqërohet me ushtrimin e dhunës ndaj grave, pasi rastet e ushtrimit të dhunës në familje përfshijnë vajza që në moshën 11 vjeç. Rezulton se format e dhunshme të komunikimit në familje fatkeqësisht takohen që në moshë fare të reja dhe vajzat përjetojnë dhunë në familje jo vetëm gjatë jetës martesore, por edhe në familjen e origjinës.

Në shumë raste vajzat martohen për t'i shpëtuar dhunës në familjen e tyre të origjinës, martesë që rezulton të jetë po aq ose më shumë e dhunshme për to, se sa mjedisi nga kanë ardhur. Këtë fakt e provojnë dhe të dhënat që vijnë nga Ministria e Brendshme, të dhëna që vërtetojnë se të dhunuarat që denoncojnë dhunën janë nga 11 deri në 57 vjeç. Pra, një jetë e tërë nën dhunë. Dy janë grupmoshat që përjetojnë më shumë dhunë, gjithnjë sipas të dhënave nga kjo ministri, mosha 18-23 vjeç dhe 37-45 vjeç. Nga pikëpamja psikologjike ushtrimi i dhunës ndaj vajzave dhe grave të kësaj moshe ka një shpjegim.

Në rastin e parë kemi të bëjmë me një moshë që ose duhet të krijojë familje (gjithnjë sipas mentalitetit mbizotërues patriarkal) ose sapo e ka krijuar atë. Në të dy këto momente vajza është ose nën presionin e familjes për t'u martuar me dikë që i servir familja dhe jo atë që ajo mund të dashurojë, ose nën presionin e bashkëshortit të ri për të mësuar sjellje dhe qëndrime bindëse ndaj tij.

Në rastin e grupmoshës së dytë (37- 45 vjeç), ushtrimi i dhunës është i lidhur me krizën e mesit të jetës, përballimin me detyra tepër të komplikuar në familje si përballja me fëmijët adoleshentë, vështirësitë për të përballuar nevojat në rritje të fëmijëve, vështirësia për të orientuar fëmijët në jetë apo vështirësi të tjera që karakterizojnë këtë stad të familjes pas 20 vitesh jetese bashkëshortore. *Faktorët që kontribuojnë në rëndimin e kësaj situatë janë:*

- *Përkufizimi i rolit të gruas/bashkëshortes në shoqëri:* mjedisi ynë social-kulturor mbart vlera e botëkuptime patriarkale të trashëguara, si i tillë rëndon shumë pozicionin e grave, historikisht të rritura nën një traditë diskriminuese gjinore. Pritshmëritë e paarsyeshme rreth rolit të gruas, mund të çojnë në nervozizma dhe humbje kontrolli. Gjithashtu vlerat kulturore që i tolerojnë sjelljet e dhunshme ndaj gruas e lehtësojnë ushtrimin e dhunës.
- *Papunësia apo stresi në punë:* gjendja e vështirë që shkakton papunësia, ashtu si dhe pakënaqësia ndaj punës ose pagës, mund të ndikojë në gjendjen emocionale të burrit, e cila mund të shprehet me sjellje të dhunshme ndaj gruas.
- *Varësia ekonomike e gruas:* mentaliteti patriarkal ka pasoja të rënda edhe në varësinë ekonomike të gruas, që megjithëse detyrohet të mos punojë për të rritur fëmijët apo sepse kështu dëshiron partneri, konceptohet si barrë për t'u mbajtur. Varësia ekonomike kthehet në një thikë me dy presa për faktin se kjo varësi bëhet shkas për ushtrim dhunë nga partneri, dhe në të njëjtën kohë e pengon atë të rebelohet apo të largohet kur ushtrohet dhunë e vazhdueshme mbi të.
- *Ndjenja paaftësie:* shumë meshkuj kur e gjejnë veten në rolin e kryefamiljarit, ndjehen të paaftë për t'i përmbushur me sukses detyrimet që i veshin këtij roli, dhe shumë shpesh ndjehen fajtorë apo të turpëruar. Këto ndjenja mund të çojnë në sjellje të dhunshme ndaj bashkëshortes.

ii) DHUNA NDAJ FËMIJËVE⁶

Përfshin keqtrajtimin ose neglizhimin e fëmijëve nga prindërit, kujdestarët, ose pjesëtarë të tjerë të familjes, që ndikohet nga faktorë si:

- *Papjekuria prindërore*: prindër të papjekur dhe të pasigurtë, të mbingarkuar me problemet e përditshme, mund të nervozohen shumë lehtë dhe si pasojë të ushtrojnë dhunë mbi fëmijët e tyre.
- *Pritshmëritë jo të arsyeshme kundrejt fëmijës*: në qoftë se një prind nuk e kupton kapacitetin dhe kufizimet e fëmijës se tij, atëherë prindi mund të mendojë që fëmija po sillet në mënyrë të gabuar qëllimisht.
- *Mungesë njohurish rreth 'prindërimit'*: të rriturit që nuk i kuptojnë nevojat e fëmijëve mund të ndjehen fajtorë dhe të pazotë. Këto ndjenja mund të bëjnë që prindërit të shfryhen tek fëmijët duke ushtruar lloje të ndryshme dhune. Gjithashtu ushtrimi i dhunës brenda ambientit familjar konceptohet nga shumë prindër si një mënyrë disiplinimi.
- *Vështirësitë ekonomike*: disa pjesëtarë të familjes mund të fajësojnë fëmijët për problemet financiare, ose të nxjerrin irritimet e tyre personale mbi ta.

Dhuna ndaj fëmijëve është *veçanërisht e rrezikshme* sepse fëmijët janë shpesh të pazotë të largohen apo të denoncojnë problemin. Pasojat psikologjike të dhunës përfshijnë nivelin e përgjithshëm emocional të fëmijës, mundësinë e zhvillimit të tij, dhe janë kultivuese të sjelljeve të dhunshmen të ardhmen.

iii) DHUNA NDAJ BURRAVE

Përhapja dhe frekuenca e kësaj dhune është shumë më e vogël në krahasim me dhunën ndaj gruas dhe fëmijëve. Ndër format

⁶ Aleanca Gjinore për Zhvillim, 2007 “Çfarë duhet të dimë rreth dhunës në familje”, Broshurë informative për të rinjtë.

më të hasura në këtë rast është ajo psikologjike për vetë faktin se dhuna fizike kërkon zakonisht një forcë fizike më të madhe, ndërsa dhuna ekonomike ndaj burrave haset rrallë pasi në vendin tonë 'ekonominë' e shtëpisë e mbajnë zakonisht burrat. *Faktorë kontribues mendohet të jenë:*

- *Vetëmbrojtja:* një nga faktorët kryesorë që i bën gratë të dhunshme, konsiderohet të jetë vetëmbrojtja nga dhuna që i ushtrohet nga partneri apo familjarë të tjerë. Kjo përbën një dramë të vërtetë shoqërore, pasi vërteton që gratë dhunojnë në pjesën më të madhe të rasteve sepse janë vetë të dhunuara.⁷
- *Konsiderimi si i 'pazoti' nga gruaja apo familjarët e tjerë:* në këtë rast kemi të bëjmë me dhunë psikologjike që ushtrohet nëpërmjet presionit që ushtron bashkëshortja apo familjarë të tjerë, ndaj burrit si sigurues kryesor të të ardhurave të familjes, sidomos në raste papunësie apo page të vogël.

iv) DHUNA NDAJ TË MOSHUARVE

Është keqtrajtimi i prindërve apo pjesëtarëve të tjerë të moshuar të familjes nga një pjesëtar më i ri. Kjo lloj dhune përfshin neglizhimin, izolimin, dhunën verbale, mjekim të tepruar, dhunën seksuale, si dhe më e përhapura, keqpërdorimin e pasurisë së të moshuarit. *Faktorë kontribues mund të jenë:*

- *Lodhja dhe stresi:* ndërhyrja e të moshuarit në punët e familjes, sëmundjet e zgjatura, presioni financiar dhe faktorë të tjerë, mund të bëjnë që familjarët të ndjehen të mërzhitur dhe të lodhur, ndjenja që bëhen shkas për ushtrim dhune ndaj të moshuarve.

⁷ Zenelaga, B. 2008 'Gratë e dhunshme, viktimat e shumëfishta të dhunës', Studime Sociale 2008, Vëll. 2, Nr.1: 89-102

- *Komoditeti i dëshiruar*: dhunuesit mund t'i japin të moshuarit qetësues, ta mbyllin atë në shtëpi ose ta lënë në mëshirë të fatit, në mënyrë që të jenë të lirë për të bërë ç'të duan.
- *Motive ekonomike*: dhuna apo kanosjet përdoren në disa raste për t'i detyruar personat e moshuar të heqin dorë nga pensioni i tyre, për të ndryshuar testamentet, etj.

Në vendin tonë ka pasur rritje në abuzimin e të moshuarve gjatë 20 viteve të fundit. Të moshuarit *mund të ngurrojnë të denoncojnë dhunën e ushtruar ndaj tyre, sepse janë të varur nga personi që i abuzon, ndjehen të turpëruar që kanë rritur fëmijë të dhunshëm, apo kanë frikë se mos dhunuesit i detyrojnë të jetojnë në azil.*

C. Dhuna në familje dhe disa Faktorë të tjerë kontribues

Një kompleks faktorësh kulturorë, socialë, ekonomikë dhe personalë bëjnë që familja shqiptare të jetë e rrezikuar nga dhuna. Shumë njerëz mund të nxjerrin në pah ndjenjat e tyre agresive, në vend që t'i shprehin ato në mënyra jo të dhunshme. Përveç atyre që përmendëm më lart, *disa faktorë të tjerë mund të jenë:*

- **Shkaqe individuale** - Që kanë të bëjnë me karakteristika dhe probleme të personalitetit si: varësia emocionale; papjekuria; kontrolli i dobët i vetes; ndjenja e inferioritetit; xhelozia; impotenca seksuale; konkurrenca intelektuale, profesionale dhe arsimore; mungesa e apatisë; vështirësi në mbajtjen e përgjegjësisë për veten; etj.. Gjithashtu, për disa njerëz, dhuna kthehet në një mënyrë për të fituar fuqi dhe kontroll mbi anëtarët e tjerë të familjes. Për ta kjo mënyrë funksionon, prandaj dhe vazhdojnë të sillen në mënyrë të dhunshme.
- **Stresi** - Shqetësimet në punë, paaftësia profesionale, problemet ekonomike, marrëdhëniet problematike, shtatëzania e padëshiruar, mund të bëjnë që një person të

ndjehet i tejngarkuar nga ana emocionale dhe kështu mund të shpërthejë në sjellje të dhunshme. Abuzimi i alkolit dhe drogës gjithashtu ndihmon në përkeqësimin e situatës.

Gjithashtu mund të përmendim të tjerë faktorë stresantë që ndikojnë në shtimin e dhunës në familje si: numrin e madh të fëmijëve; bashkëjetesën në familje me disa kurora; ndërhyrjet në jetën e çiftit; prindërimi i vetëm; kufizimet në mundësitë për një jetë normale; sëmundje të zgjatura apo kronike; vdekja e ndonjë personi të afërt; etj.

- **E kaluara e familjes** - Studimet kanë treguar se shumë njerëz mësojnë të sillen në mënyrë të dhunshme me pjesëtarët e familjes, gjatë rritjes së tyre. Për shembull, fëmijët e abuzuar kur rriten, mund të manifestojnë dhunë ndaj familjes së tyre. Në shoqërinë shqiptare, e kaluara e dhunshme e familjeve të prejardhjes është një nga faktorët kryesorë që ndikon në lindjen dhe shtimin e sjelljeve të dhunshme brenda familjeve të reja.
- **Izolimi** - Me komunikimin dixhital në shoqërinë e sotme, shumë njerëz vuajnë pasojat e një izolimi social, pra humbin kontaktin emotiv me familjen dhe miqtë, të cilët janë burimet kryesore të mbështetjes emocionale për të cilën secili nga ne ka nevojë. Këta njerëz mund të ndihen të vetmuar, pa ditur kujt t'i drejtohen për ndihmë dhe kjo mund të çojë në sjellje të dhunshme brenda familjes.
- **Pabarazitë gjinore** - Gjithashtu, mënyra se si shoqëria e konsideron dhunën në përgjithësi dhe si reflektohet nga media, varfëria dhe papunësia, pabarazitë gjinore, niveli i lartë i stresit, rënia e konsiderueshme e nivelit të arsimimit, humbja e besimit në institucionet shtetërore, vështirësitë në zbatimin e ligjit mbi dhunën në familje, modelimi i sjelljeve agresive që shfaqen në sferën politike, mungesa e shërbimeve në mbështetje të familjeve, paqëndrueshmëria politike dhe ekonomike, varfëria, etj, janë faktorë që ndikojnë në shtimin e dhunës.

D. Pasojat e Dhunës në Familje

Sipas Raportit Botëror Mbi Dhunën dhe Shëndetin të vitit 2000, statistikat globale të viktimave të dhunës në familje që kanë përfunduar të vrarë janë katastrofike. Tashmë, ekziston evidencë e bollshme në literaturë lidhur me pasojat fizike dhe psikologjike të dhunës në familje, pasoja të cilat, mund të jenë afatshkurtra, afatmesme, ose afatgjata.⁸

‘Dhuna ndaj grave në familje është dhunim i të drejtave të njeriut. Ajo është një realitet i përditshëm për gratë kudo që ato ndodhen në çdo vend të globit. Ndikimi i saj është shkatërrues për gratë, jetët e tyre, shëndetin, punën dhe mirëqenien e familjes së tyre.’

14 Pikat e programit dhe informacione të tjera mund t’i gjeni në faqen e internetit: <www.amnesty.org/actforwomen>, AI Index: ACT 77/012/2006

Dhuna në familje ka pasoja të rënda tek viktimat pasi ajo dëmton shëndetin, vetë-vlerësimin, sigurinë, cilësinë e jetës dhe mundësitë dhe potencialin e viktimës për të kontrolluar jetën e tij/saj. Pasoja më e rëndë e dhunës ndaj grave dhe vajzave është mohimi i të drejtave të tyre njerëzore. Mohimi i të drejtave njerëzore, përveç se vetë viktimat, prek familjet e tyre, komunitetin në të cilin ato jetojnë, e të gjithë shoqërinë.

Më poshtë do përmendim disa nga pasojat kryesore të dhunës në familje, që fatkeqësisht shumë shpesh hasen të kombinuara me njëra tjetrën:

⁸ Tamo, A. dhe Karaj, Th. Korrik 2005 “Dhuna kundër Fëmijëve në Shqipëri” Qendra e Zhvillimeve Humane, Tiranë, fq 16.

Dhunimi i të drejtave të njeriut – Pasoja kryesore është shkelja e rëndë që i bëhet të drejtave të njeriut në çdo rast të dhunës në familje. Të gjithë pa dallim gëzojmë të drejtën e respektimit të të drejtave themelore të njeriut dhe duhet të reagojmë kur këto të drejta na dhunohen.

Dëmtime fizike serioze që mund të jenë të përkohshme ose të përhershme. Dhuna në familje mund të finalizohet dhe me vdekjen e të dhunuarit, gjë që në Shqipëri është kthyer në një rutinë, që për fat të keq mbush kryeartikujt e gazetave të përditshme, gjithnjë e me shpesh. Disa prej pasojave fizike afatgjata janë: invaliditet (gjymtim) i përhershëm; dëmtime të përhershme të trurit që manifestohen me çrregullime të disa funksioneve shumë të rëndësishme si ruajtja e ekuilibrit, rregullimi i temperaturës së organizmit, proceset e njohjes, etj.; dëmtime të përhershme të sistemit nervor qendror që mund të manifestohen me paraliza të ndryshme; pasoja në traktin riprodhues, si infertilitet, çrregullime të përhershme të funksionit të organeve gjenitale, SST, HIV SIDA; etj.

Shqetësime psikologjike dhe të sjelljes si: çrregullimi post-traumatik i stresit; çrregullime psiko-somatike; depresion i shkallëve të ndryshme; humbja e vlerësimit për veten; frikë dhe ankth i pashkak; humbje shpresash; zhvillim i ndjenjës së turpit dhe të fajit; tentative për vetëvrasje apo vete-dëmtime të ndryshme; dëmtime të aparatit njohës; etj.

Probleme me punën - E fundit nga pasojat por jo më pak e rëndësishme, pasi viktimat mund të humbin punën dhe të ardhurat që derivonin prej saj. Ky është një shqetësim shumë serioz që shpesh bën që viktimat të mos denoncojnë dhunën, për shkak të varësisë ekonomike nga dhunuesi. Gjithashtu, dhuna në familje mund të çojë në çrregullime serioze të familjes së viktimës dhe të jetës së saj/tij personale në të gjitha prizmat.

E. Kostot Social – Ekonomike të Dhunës në Familje

Studimet që kanë dokumentuar efektet ekonomike të dhunës në familje kanë përdorur një numër të madh zërash të kostos. Disa lloje studimesh janë përdorur nga ekspertë të kësaj fushe për të llogaritur sa më mirë koston e përgjithshme të dhunës në familje në varësi të formës (dhunë ndaj grave, fëmijëve, apo të moshuarve), frekuencës dhe intensitetit të ushtrimit të dhunës. Gjithsesi, duhet theksuar fakti që studiuesit dhe profesionistët e kësaj fushe e pranojnë gjerësisht faktin se është thuajse e pamundur që të përftohet një vlerësim i saktë i kostos reale të dhunës në familje. Kjo për faktin se dimensionet psikologjik dhe emocional të dhunës së ushtruar është shumë i vështirë për t'u shprehur në terma ekonomike. Pavarësisht nga këto kufizime në llogaritjen e kostos reale të dhunës së ushtruar, specialistët kanë përfutur disa vlerësime të përafërta të kostos së dhunës në familje të cilat mund të jenë indirekte dhe direkte.

- **Kostot Indirekte** përfshijnë të gjitha kostot që rezultojnë në mënyrë të tërthortë nga akti i dhunës së ushtruar. Në këto kosto përfshihen: humbja e të ardhurave dhe e kohës; humbja e investimit në kapitalin human; kostot indirekte për mbrojtjen dhe sigurinë e viktimave të dhunës; kostoja e sigurimit për jetën e të dhunuarve; kostoja e përmirësimit të ligjit dhe strategjisë për parandalimin e dhunës në familje; kostoja psikologjike dhe emocionale e viktimave të dhunës; si dhe kosto të tjera jo-monetare.
- **Kostot Direkte** përfshijnë të gjitha llojet e kostove që rezultojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga akti i dhunës së ushtruar. Këto kosto përmbledhin: kostot e shërbimeve ligjore në raste dhune; kostot shëndetësore direkte (ndihma mjekësore ndaj të personit të dhunuar); kostot direkte për kontrollin e dhunuesit; kostot e shërbimeve policore; kostot

e burgosjes së dhunuesve; kostot direkte të shërbimeve rehabilituese; si dhe kostoja e kontratave të sigurisë private.

Kostot direkte më të zakonshme përfshijnë koston e shërbimeve shëndetësore si dhe koston e shërbimeve të rendit publik dhe të drejtësisë (polici dhe sistem gjyqësor). Kostot indirekte më të zakonshme përfshijnë efektet afatgjata të dhunës së ushtruar (p.sh. efekte psiko-emocionale tek viktimat e dhunës). Shpeshherë, kostoja e dëmtimeve psikologjike dhe emocionale në viktimat e dhunës në familje është më e lartë në krahasim me koston direkte ekonomike.

Shumë studime në të gjithë botën kanë treguar se dhuna ndaj grave ndikon që ato të humbasin më shpesh vendin e punës si dhe të kenë të ardhura ekonomike më të ulëta. Kjo bën që shumë gra të dhunuara të marrin asistencë ekonomike nga shteti për të përballuar një jetesë minimale. Si rrjedhojë, përveç efekteve shëndetësore, dhuna ndaj grave mbart edhe një kosto të lartë ekonomike dhe sociale. Abuzimi fizik, seksual, apo psikologjik ndaj grave çon në humbje të mëdha të investimit në kapitalin njerëzor. Prandaj, kostoja socio-ekonomike e këtij problemi është shumë më e lartë se ajo çfarë dokumentohet sot në të gjitha vendet e botës.⁹

F. Mite rreth dhunës ndaj grave

Ekzistojnë disa mite të gabuara në shoqërinë tonë që mundohen të justifikojnë sjelljet e dhunshme ndaj grave. Disa prej tyre janë:

- Dhuna është një problem i të varfërve.
- Gratë e dhunuara qëndrojnë në marrëdhënie të dhunshme sepse ato e pranojnë dhunën.

⁹ Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim, Prill 2006. Dhuna në familje 'Një paraqitje e situatës aktuale në Shqipëri, Tiranë.

- Dhuna në familje është rastësore dhe ndodh shumë rrallë.
- Dhuna në familje është një problem i çiftit që e përjeton atë, askush nuk ka të drejtë të ndërhyjë, as policia, as shteti, e as ligji.
- Janë të pakta gratë që rrihen nga burrat apo familjarët e tyre.
- Gratë dhe fëmijët keqtrajtohen vetëm në familjet me probleme dhe jo në familjet normale.
- Gratë e dhunuara kanë personalitete të caktuara që e nxisin ushtrimin e dhunës nga bashkëshorti.
- Gruaja ka nevojë të rrihet herë pas here për t'i treguar vendin.
- Kush të rreh, të do.
- Gratë e kërkojnë vetë dhunën se vishen dhe sillen në mënyra të papërshtatshme.
- Burrat i dhunojnë gratë ngaqë konsumojnë alkol, jo sepse duan të keqtrajtojnë gruan.
- Të denoncosh është e kotë, se do të bëjë që të acarohet më shumë gjendja.
- Dhuna prek vetëm një shtresë apo grupe të caktuara.

G. Frekuenca/Statistika të dhunës në familje në Shqipëri

Raporti Botëror Mbi Dhunën dhe Shëndetin i vitit 2000, i publikuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, paraqiti në detaje situatën botërore të këtij fenomeni. Statistikat globale raportuan se rreth 520,000 viktime të dhunës në familje kanë përfunduar të vrarë. Ky numër mendohet të jetë padyshim më i madh duke pasur parasysh nën-raportimin dhe mangësitë në sistemet e informacionit në shumë vende të botës.

Për sa i përket të dhënave nga Shqipëria, raportohen faktet e mëposhtme:

- Sipas një studimi të vitit 1996 të kryer në një kampion përfaqësues kombëtar të grave në Shqipëri (849 gra), përhapja e dhunës ndaj tyre (fizike, seksuale, apo psikologjike) u raportua të ishte 64%.
- Sipas një studimi të kryer në Tiranë në vitin 2003 i cili përfshiu një kampion përfaqësues prej 1039 grash të martuara, përhapja e dhunës fizike u raportua të ishte e lartë. Kështu, së paku një episod i dhunës fizike (gjatë vitit të fundit) u raportua nga 37% e grave të intervistuar, ndërkohë që 26% e grave raportuan së paku tre episode të dhunës fizike gjatë vitit të fundit. Përhapja e dhunës fizike ishte më e lartë tek gratë, burrat e të cilave kishin një nivel edukimi prej jo më shumë se 9 vitesh dhe ishin me origjinë rurale.
- Sipas një publikimi të *Amnesty International (Prill 2006)*, 1 në 3 gra në Shqipëri, është dhunuar fizikisht brenda familjes së saj. Në shumicën dërrmuese të rasteve, të përgjegjshëm për aktet e dhunës janë partnerët e tyre. Po sipas këtij publikimi 52.2% e grave që vuajnë nga dhuna në familje, nuk u kanë folur kurrë të tjerëve për dhunën e ushtruar ndaj tyre. Kjo shifër shpreh mungesën e ndërjegjësimit të grave, që nuk e shohin dhunën si një akt që duhet denoncuar. Gjithashtu rezultoi se 11.5 për qind e vajzave dhe grave shqiptare të grupmoshës 15-44 vjeç, kur kanë qenë fëmijë kanë qenë dëshmitare të dhunës në familje dhe 27.2 për qind e tyre kanë qenë viktimat e dhunës fizike në familje gjatë fëmijërisë.
- Sipas një monitorimi të katër periodikëve kryesorë shqiptarë të bërë nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, vetëm gjatë periudhës Korrik-Gusht 2008 kanë ndodhur 26 raste vetëvrasjesh të gratë e vajzat. Nga analizimi i artikujve për rastet e vetëvrasjeve shikohet se ndër shkaqet kryesore janë *dhuna në familje* dhe problemet ekonomike.

- Duke iu referuar statistikave në raportin 6-mujor të policisë shkruar në artikullin *“Vetëvrasjet, sa dyfishi i vrasjeve”* (Panorama, 27.07.08) gjatë këtij 6-mujori, 88 është numri i krimeve kundër vetes ku: 73 raste janë vetëvrasje dhe 15 tentativa për vetëvrasje, kjo tregon një numër relativisht të lartë në krahasim me vrasjet, të cilat për këtë gjysëm viti kanë qenë 44 raste. Sipas raportit të policisë thuhet se dhuna në familje klasifikohet si një nga shkaqet kryesore të vetëvrasjeve, ku në 95% të rasteve të shytyra nga dhuna, të dhunuarat kanë qenë bashkëshortet, vajzat dhe nënat. Pra, gratë vazhdojnë të mbeten seksi më i diskriminuar dhe më i dhunuar në familje, gjë që po reflektohet edhe në rastet e vetëvrasjeve, si pasojë e dhunës në familje. Në raport theksohet se *“...mbi 50% e rasteve të denoncuara i përkasin Tiranës, ndërsa në rrethe duket se konsiderohet ende tabu denoncimi prej të dëmtuarve i dhunës së ushtruar në familje”*.
- Nga të dhënat nga një studim i pabotuar i Bejleri, F. (2008) mbi *Dhunën në Familje e Raportuar në Gjykatë* rezulton se vetëm gjatë gjashtë-mujorit të parë të vitit (Janar- Korrik) 2008, në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Shkodër dhe Vlorë, janë regjistruar në total 3525 çështje civile me objekt zgjidhje martese dhe çështje penale të përgjithshme prej të cilave **919** çështje civile me objekt zgjidhje martese dhe **2606** çështje penale të përgjithshme. Nga analizimi i të dhënave të mbledhura nga ky studim, ka rezultuar se: në të tre gjykatat në total, nga **3525** çështje Civile dhe Penale - **421** çështje janë me dhunë të raportuar. Në të tre gjykatat në total, nga **919** çështje civile me objekt zgjidhje martese - **152** çështje janë me dhunë të raportuar. Gjithashtu, nga **2606** çështje penale të përgjithshme - **269** çështje janë me dhunë në familje me kërkesë për Urdhër Mbrojtjeje.

Të dhënat mbi përhapjen e fenomenit të dhunës në familje vazhdojnë të jenë të kufizuara. Kështu komisaritet e policisë, zyrat juridike, qendrat e kujdesit shëndetësor dhe ato të shërbimeve sociale nuk janë të detyruara me ligj të

grumbullojnë dhe prezantojnë të dhëna mbi dhunën. Shqipëria është një nga vendet e pakta në Europë që nuk regjistron, publikon dhe prezanton zyrtarisht rregullisht të dhëna mbi përmasat dhe përhapjen e këtij fenomeni.

2. KUADRI LIGJOR DHE I POLITIKAVE NË SHQPËRI

A. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998)

Kushtetuta e Shqipërisë (1998), në nenin 18 të saj, përcakton se “të gjithë shtetasit janë të barabartë përpara ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla, si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore e sociale”.

B. Kodi i Familjes (2003)

Kodi i Familjes, i miratuar më 08.05.2003, Ligji Nr. 9062, parashikon të drejta të barabarta midis burrit dhe gruas që të zgjedhin lirisht për t’u martuar apo divorcuar, si dhe të drejtat dhe detyrat e ndërsjella në familje për edukimin dhe rritjen e fëmijëve.

C. Ligji ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’

Ligji Nr. 9669, dt. 18.12.2006, ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’, i cili u aprovua nga Parlamenti dhe ka hyrë në fuqi më 1 Qershor 2007, përbën rastin e parë të aprovimit të një ligji me iniciativën e 20 mijë zgjedhësve, në mbështetje të projektit të hartuar nga disa organizata joqeveritare aktive në fushën e mbrojtjes së të drejtave të grave, fëmijëve dhe grupeve të rrezikuara. Ky hap ishte një përvojë e

re dhe për parlamentarizmin në Shqipëri, pasi prezantoi një procedurë të re legjislative, pak të njohur në vendin tonë dhe aspak të praktikuar deri atëherë. Nga ana tjetër, numri i nënshkrimeve të mbledhura për këtë iniciative ligjore, nxori në pah një fakt të rëndësishëm të rritjes së ndjeshmërisë së opinionit publik ndaj temave tabu të dhunës në familje. Për më tepër, kërkesa për të aprovuar një ligj, në këtë rast ishte më tepër se thjesht ndjeshmëri ndaj një problematike të dënueshme shoqërisht, ishte një thirrje për ndërhyrje me mjete ligjore e me forcën e shtetit ndaj dukurisë së dhunës në familje.

Ky ligj vjen si vijues i disa hapave të mëparshëm të ndërmarrë në kuadër të konsolidimit të sistemit ligjor shqiptar në fushën e masave parandaluese dhe ndëshkuese ndaj dhunës në familje, por edhe si detyrime ndaj Kushtetutës dhe konventave të tjera të nënshkruara nga shteti shqiptar, siç është Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) dhe përafrimit të legjislacionit shqiptar me standartet ndërkombëtare dhe rekomandimet e BE-së.

Hapa paraprake ishin Ligji Nr. 9198 dt 01.07.2004 *'Për një shoqëri gjinore të barabartë'*, i cili shënoi një progres të vlefshëm me aprovimin e tij, në mënyrë të veçantë me zhvillimin e parimeve të diskriminimit, por sidoqoftë, nuk pati një zbatim intensiv, për më tepër që nuk u shoqërua me akte nënligjore që do të mbështesnin zbatimin e këtij ligji.

Në këtë terren ligjor u përgatit dhe u miratua ligji *'Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare'*, i cili është pranuar të ketë sjellë ndryshime pozitive (OSCE 2008, Anastasi, et. al 2008), të cilat janë ende në fazë embrionale (që është dhe e pritshme duke iu referuar kohës që nga miratimi i tij) të cilat, gjithsesi duhen çuar më tej dhe me rritje të ndërgjegjësimit të të gjithë shoqërisë, dhe opinionit publik, ku media luan një rol thelbësor. Një hap tjetër që pritet të sjellë forcimin e zbatimit të ligjit është dhe plotësimi i tij me akte të tjera nënligjore, që do të mundësonin aktivizimin e plotë të strukturave të parashikuara në ligj, për pasojë rritjen e efektshmërisë.

Ligji sjell disa elemente të rinj, si nga ana e procedurave legjislative ashtu dhe nga ana e përmbajtjes dhe rolit që i njeh institucioneve ekzekutuese dhe rehabilituese, duke e shtrirë vëmendjen jo vetëm ndaj viktimës, si parësore, por dhe ndaj dhunuesit, duke e paraparë këtë si një masë jo vetëm riparuese por dhe parandaluese në të ardhmen, një element që, siç pranon Anastasi (2008), përbën një nga pikat më të forta të ligjit. Ky nuk është mirëfilli një ligj penal, për shkak se ai parashikon mjete të posaçme administrative-civile, duke u ofruar shërbime të mbrojtjes dhe strehimit viktimave të dhunës, në bazë të urdhrave mbrojtës të gjykatës (Idem).

Ligji parashikon dy tipe urdhrash mbrojtjeje – urdhër mbrojtjeje i menjëhershëm dhe urdhër mbrojtjeje. I pari lëshohet nga gjykata menjëherë dhe është me fuqi të përkohshme deri sa del urdhri i mbrojtjes, zbatohet në rastet kur dhuna paraqet “rrezik të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm ndaj sigurisë, mirëqenies ose shëndetit të anëtarëve të tjerë të familjes”. Në rastin e dytë, urdhri i mbrojtjes lëshohet me vendim gjykate dhe parashikon masa mbrojtëse për viktimën/viktimat e dhunës në familje.(OSCE, 2007)

Në këtë kuadër ligji sjell dhe një progres të rëndësishëm kur përcakton qartë rolin e autoriteteve përkatëse shtetërore, detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në nivel të qeverisjes qendrore dhe lokale, duke filluar nga Ministria e Punës, si autoritet përgjegjës që mundëson zbatimin e ligjit, deri të autoritetet lokale, si bashkitë e komunat.(Anastasi, 2008).

Sidoqoftë, ligji duhet të pajiset me akte mbështetëse nënligjore që do të mundësonin realizimin me sukses të tij në të gjitha aspektet.

D. Zbatimi i ligjit ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’

Ligji ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’ është

një ligj me fuqi jo vetëm parandaluese ndaj dhunës së ushtruar në marrëdhëniet familjare, por edhe një mjet i fuqishëm që synon reduktimin e fenomenit. Ai është një mjet që u ofron ndihmë të gjithë atyre që janë të ekspozuar dhe ndihen viktimë të kësaj dhune, por në mënyrë të veçantë, duke iu referuar fakteve që mes viktimave, gratë e fëmijët janë më të dhunuarit, ai i merr në mbrojtje të veçantë këto grupe.

Ndonëse që nga koha që ligji ka hyrë në fuqi ka kaluar pak më shumë se një vit, rezultatet e para janë vënë në dukje – siç pranohet në raportin *'Mjetet ligjore që ofron Ligji 'Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare' dhe ndikimi i tij në luftën ndaj këtij fenomeni, vërtet është ende herët për të diskutuar një parandalim tërësor të fenomenit 'dhunë', por është pozitive të flitet për rritje të ndërgjegjësimit të qytetarëve. Së pari për të kuptuar se dhuna nuk duhet pranuar në heshtje por ndaj saj duhet reaguuar dhe për këtë tanimë ka mjete, ashtu si dhe një lloj arsytimi se dhuna nuk zgjidh asnjë problem, përveçse dëmton. (Anastasi, 2008).*

Një tjetër tregues të cilit do t'i referohemi në mbështetje të argumentit se ligji ka sjellë ndryshime me kah pozitiv në raport me raportimin e dhunës, është ai që vjen nga studimi i kryer nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare mbi monitorimin e zbatimit të ligjit Nr 9669 përmes urdhrave të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e Vlorë për periudhën 01.07.2007 - 30.04.2008. Numri i denoncimit të rasteve të dhunës ka shënuar një rritje me rreth 10% nga viti 2007 në vitin 2008 (Anastasi, 2008). Ndër këto raste të denoncuar, Gjykata e Tiranës ka lëshuar 18 *urdhra të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhra mbrojtës*, dhe Gjykata e Vlorës 2 të tilla. Sidoqoftë, ky numër nuk është i lidhur me rastet e ushtrimit të dhunës në familje, niveli i raportimit të saj në krahasim me ushtrimin është në favor të këtij të fundit. Në përgjithësi, opinioni është skeptik lidhur me fuqinë vepruese të ligjit për parandalimin e dhunës dhe garantimin e anëtarëve të familjes ku është ushtruar dhunë. Sipas studimit të përmendur, kjo ndjesi

nuk vjen vetëm nga fakti se anëtarët janë të frikësuar nga efektet e hakmarrjes që do të ngjallte ushtrimi i një veprimi ligjor ndaj dhunuesit, por më së shumti nga mosbesimi që kanë ndaj aparatit legjislativ.

Raporti i monitorimit të ligjit nxjerr në pah se dhuna fizike dhe psikologjike e kombinuar, ushtrohet në një përqindje mjaft të lartë (rreth 65% e rasteve të analizuara), dhe në pjesën më të madhe ato janë gra (60% e rasteve të monitoruara) dhe 35% fëmijë. Urdhrat në këto raste janë lëshuar duke u bazuar në denoncimet dhe raportet mjekësore apo dhe evidenca të tjera, si mbajtja në komisarjat e dhunuesit, fotografitë e pasojave të dhunës së ushtruar, etj. Përqindja më e lartë e rasteve të monitoruara i referohet marrëdhënieve bashkëshortore, megjithatë ky ligj i zgjeron spektrin e mbështetjes dhe ndihmës duke marrë nën mbrojtje dhe anëtarë të tjerë të familjes. Rezultatet e studimit tregojnë se përqindja më e lartë e dhunuesve janë të moshën më aktive 36-45 vjeç dhe vjen e bëhet më e ulët në mosha më të larta. Gjithashtu, rezulton të jetë mjaft i lartë (77.75% e rasteve të marra në shqyrtim) numri i rasteve të dhunuesve që janë të papunë – kjo evidenton dhe faktin se problemet e mprehta sociale bëhen shkak dhe janë në thelb, gjeneruese të dhunës në familje.

Në zbatim të masave mbrojtëse të ligjit është interesante të vihet në dukje një fakt - kalimi nga Urdhrat e Menjëhershëm të Mbrojtjes në Urdhra Mbrojtjeje – vetëm në 16.6% të rasteve gjykata ka lëshuar këtë urdhër të dytë, në raste të tjera çështjet janë pushuar sepse pala paditëse ka hequr dorë.

Një tjetër element i rëndësishëm në këtë diskutim është përfaqësimi i viktimës në gjykatë. Sipas ligjit ky përfaqësim duhet të asistohet falas, por në realitet pothuajse nuk ndodh. Analizat e të dhënave tregojnë se Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka dhënë asistencë në 45% të rasteve, me një tendencë të rritjes së kësaj asistence në vitin e fundit krahasuar me vitin paraardhës.

Nga një vështrim i përgjithshëm i situatës së zbatimit të urdhrave mbrojtës, është konstatuar se në përgjithësi, sa kohë ka një urdhër të tillë dhunuesi i ka zbatuar masat e ligjit, por me mbarimin e afatit situata ka ndryshuar dhe duket se predispozita e dhunuesit për të ushtruar dhunë është kthyer sërish. Kjo përbën dhe një nga pikat e dobëta të ligjit – vërtet ia heq dhunuesit të drejtën e të jetuarit në një vend me palën tjetër, duke rritur shanset për një jetë më të mirë të viktimës së dhunës, por nga ana tjetër, nëse ky person nuk do të ketë strehim të sigurtë, ai bëhet dhe më shumë bartës i problemeve sociale, madje dhe më komplekse.

Për të qenë sa më funksional, ky ligj duhet të pasurohet dhe me akte nënligjore që do të trajtonin dhe aspekte të tjera specifike të tij.

E. Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje

‘Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje 2007-2010’ është një ndër dokumentat strategjikë të shtetit shqiptar që bën pjesë në grupin e strategjive dhe planeve të veprimit që i shoqërojnë ato në kuadër të NSDI - Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Ky është një dokument i hartuar mbi bazë të një procesi të gjerë konsultimi dhe debati mes grupeve të interesit dhe përgatitjeje nga grupe pune me ekspertë ligjorë, të çështjeve sociale, etj., dhe pasqyron në përmbajtjen e tij drejtimet e Planit të Veprimit të Pekinit, rekomandimet e Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, arritjen e Objektivave të Mijëvjeçarit dhe rekomandimet e KE-së. Problematika e çështjeve të barazisë gjinore dhe të dhunës në familje në shoqërinë shqiptare dhe hapat për t’ju përgjigjur këtyre dukurive, si kërkesa prioritare të kohës për t’i njohur gruas rolin në shoqëri, detyrimet ligjore të shtetit shqiptar si pasojë e

nënshkrimit të akteve ligjore ndërkombëtare, si dhe proceset integruese, përgatitën terrenin për formësimin e kësaj strategjie me rëndësi kombëtare, e cila, në përfundim të të gjitha proceseve përgatitore, u aprovua me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 913, datë 19.12.2007.

Dokumenti strategjik trajton në mënyrë të balancuar të dy çështjet: barazinë gjinore dhe dhunën në familje, të cilat në një farë mënyre i përgjigjen dy strategjive respektive. Të dy pjesët kanë lidhje organike, aq sa dhe kanë pikat e dallimit dhe linjat e pavarura të zhvillimit të tyre. Ndonëse ky fakt përbën epërsi krahasimore, jo rrallë është kritikuar nga aktivistët e çështjeve gjinore.

Në pikëpamje të ndërtimit, dokumenti është konceptuar mbi bazën e tre kapitujve themelorë të cilët japin fillimisht *pamjen aktuale* duke bërë analiza të situatës konkrete, duke analizuar legjislacionin aktual, edhe institucionet e ngritura mbi bazë të kësaj strukture juridike. Më pas, analizojnë *vizionin* që synohet të arrihet për t'ju përgjigjur rrethanave të situatës në shoqërinë shqiptare dhe së fundmi, hapin udhë për perspektiva të ndërtimit të këtij vizioni duke dhënë rekomandimet e nevojshme për hartimin e *politikave* përkatëse.

Analiza aktuale e situatës gjinore në sektorët e tregut të punës, shërbimeve sociale e shëndetësore, të arsimit e medias, jetës publike e politike, nxjerr në pah se gruaja ka arritur të konsolidojë një pozitë në shoqëri, por gjithsesi kjo pozitë është ende mjaft e dobët për shkak të një mentaliteti mbizotërues mashkullor në shoqëri (Studim i situatës së barazisë gjinore në Shqipëri, 2008) dhe stereotipave që diskriminojnë jo rrallë aftësitë dhe zgjedhjet e grave. Ndërkohë, analizat nxjerrin në pah se fenomeni i dhunës në familje është mjaft i pranishëm, shfaqet në shumë forma dhe prek kryesisht vajzat, gratë, fëmijët dhe të moshuarit.

Nga ana ligjore, strategjia nxjerr në pah faktin se vërtet Kushtetuta e Shqipërisë sanksionon barazinë e burrit me gruan para ligjit, por në praktikë kjo nuk është shpesh e realizuar.

Analiza e situatës nxjerr në pah se, janë të dobëta ose mungojnë akte ligjore dhe nënligjore që do të fuqizonin rolin e gruas në jetën private dhe publike dhe për pasojë dhe institucionet që do të mbështesnin këto akte.

Në Strategji sanksionohet dhe vizioni për arritjen e barazisë dhe ndalimin e dhunës sipas të cilit:

- Zhvillimi ekonomik dhe social i vendit dhe hartimi e zbatimi i politikave të përshtatshme për realizimin e barazisë gjinore, do të shërbejnë si premisë për programimin e objektivave që lidhen me barazinë gjinore, aksesin e barabartë midis burrave dhe grave në vendimmarrje në nivel qendror e vendor, në fushën e arsimit, shëndetësisë, punësimit, shërbimeve publike, parandalimin e dhunës në familje, etj.
- Në përmbushjen e këtij vizioni strategjik, dokumenti rekomandon prioritetet strategjike, dhe thekson faktin e rëndësishëm se veprimet konkrete duhen ndërmarrë të koordinuara dhe të mbështetura financiarisht e me afate kohore reale.

Në kapitullin e politikave, dokumenti i strategjisë vjen me rekomandime specifike sipas fushave të ndërhyrjes (përmendur më lart) për të vënë në jetë ato nisma e aksione konkrete që do të shërbejnë në arritjen e vizionit. Pajisja e strategjisë me një Plan Veprimi të detajuar - në objektiva, masa zbatuese, buxhet përkatës, tregues të matshëm dhe afate kohore për realizimin e tyre - përbën një arritje, ndonëse mbetet sfidë ndarja e mjeteve financiare në buxhetin vjetor.

Prioritetet Strategjike të kësaj strategjie janë

- Forcimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë mbrojtës me qëllim sigurimin e barazisë gjinore në Shqipëri.
- Fuqizimi i gruas nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së saj në vendimmarrje;

- Fuqizimi ekonomik i gruas dhe rritja e mundësive të saj për punësim dhe kualifikim profesional;
- Promovimi i aksesit të barabartë të grave dhe vajzave në arsimin cilësor;
- Përmirësimi i situatës sociale të grave dhe vajzave në risk nëpërmjet rritjes së qasjes së tyre ndaj shërbimeve sociale cilësore.
- Përmirësimi i shëndetit të popullsisë duke rritur përgjigjen e sistemit shëndetësor, ndaj nevojave të veçanta shëndetësore të grave/ vajzave dhe burrave,/ djemve.
- ***Përmirësimi i rolit të medias për një mentalitet të ri, që i përgjigjet zhvillimit të kohës, lidhur me barazinë gjinore në shoqëri dhe rritjen e përfaqësimit të grave dhe vajzave në këtë profesion.***
- ***Rritja e ndërgjegjësimit ndaj dukurisë së dhunës, mbrojtje ligjore dhe administrative si dhe mbështetje për individë të prekur nga dhuna në familje dhe dhunuesit.***

Për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje, autoriteti përgjegjës është Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, e cila ka si qëllim të nxisë barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e gruas në jetën e vendit.

F. Ligji ‘Për barazinë gjinore në Shoqëri’

Iniciativa legislative vijuese më e fundit, është ligji i ri i sapo miratuar nga Parlamenti Shqiptar më 24 korrik 2008 ‘Për barazinë gjinore në shoqëri’, i cili synon: mbrojtjen e qytetarëve ndaj çdo lloj diskriminimi me bazë gjinore; garantimin e

mundësive të barabarta si për meshkujt dhe femrat për të arritur standarte sa më të larta në fushën e barazisë gjinore; integrimin gjinor; krijimin e strukturave të reja politike-bërëse, ekzekutuese dhe mbrojtëse; parashikimin e masave të veçanta të përkohshme në vendimmarrjen politike, siç është rasti i kuotës neutrale në masën jo më pak se 30%; ndërmarrjen e masave të posaçme në fushën e arsimit, punësimit; etj. Ligji i ri, i hartuar nga grupe ekspertësh të fushave juridike dhe çështjeve gjinore, i cili u paraqit nga MPÇSSHB në Këshill të Ministrave gjatë 2007, gjeti mbështetjen e gjerë të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në vend, dhe u diskutua gjerësisht me grupet e interesit në të gjitha nivelet.

3. RAPORTIMI I DHUNËS NË FAMILJE NË MEDIA

A. Raportimi i dhunës në familje në median shqiptare

Vite më parë kur u realizua ndryshimi i sistemit, shumëkush mendoi se krijimi i shtypit pluralist ishte në vetvete zgjidhja e tërë problemeve të shtypit shqiptar. Shumë shpejt u kuptua se garantimi i pluralizmit dhe i lirisë së shprehjes ishte vetëm një etapë e rëndësishme në shndërrimin e medias shqiptare por jo etapa e fundit. Pasi siguruan pluralizmin, mediat shqiptare duhej të plotësonin standartet profesionale dhe ato etike. Duhet pranuar se mediat shqiptare nuk i kanë realizuar ende standartet etike dhe profesionale të mediave të vendeve më të zhvilluara demokratike. Një nga treguesit e mungesës së këtyre standarteve profesionale dhe etike është edhe rasti i raportimit të problematikave gjinore në media dhe raportimi i dhunës në familje.

Në pamje të parë duket se raportimi i dhunës në familje është në fokus të mediave shqiptare. Kjo përshtypje të krijohet nga fakti se mediat shqiptare i botojnë lajmet për dhunën në familje shpeshherë në faqet e para të gazetave apo në titujt e lajmeve kryesore të mediave elektronike. Në të vërtetë shtypi shqiptar është shumë i ndjeshëm ndaj krimit në familje, por jo ndaj dhunës në familje. Është e vërtetë se kur ndodh një krim në familje mediat shqiptare i kushtojnë mjaft rëndësi duke e “shfrytëzuar” maksimalisht ngjarjen nga pikëpamja mediatike, pasi ngjarje të tilla “përbëjnë” lajm me interes për publikun. Mediat raportojnë kështu vetëm anën “spektakolare” të dhunës

në familje duke u shndërruar në industri që e mbajnë publikun të interesuar vetëm për këtë spektakël. Por ndërkohë, mediat raportojnë pak ose aspak për mijëra ngjarje të tjera dhune që nuk përfundojnë me vrasje. Në raport me rastet e dhunës në familje që përfundojnë me vrasje, këto të fundit janë më të shumta. Megjithatë ato nuk i paraqiten publikut. Nëse do t'i paraqiteshin, natyrisht do pakësoheshin rastet e viktimave të shkaktuara nga krimi në familje.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i mungesës së profesionalizmit të mediave ka të bëjë me faktin se raportimi i rasteve të dhunës në familje trajtohet si të gjitha lajmet e kronikës së zezë. Si e tillë, ajo vetëm raportohet në elementët e saj konfliktualë, por trajtohet shumë rrallë me kontekstin e saj shoqëror. Çdo krim në familje ka një kontekst të caktuar shoqëror dhe ka në fillesë të tij një pabarazi apo padrejtësi shoqërore. Një gazetari profesional dhe e angazhuar në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve duhet të shkojë në origjinë të akteve të dhunës, të zbulojë shkaqet e këtyre akteve dhe t'ia raportojë publikut. Kjo gjë nuk ndodh. Në përgjithësi raportimi i dhunës në familje është një raportim i cili ndalon në atë që Mencher e quan *“shtresa e parë e raportimit”*, ku përfshihen të dhënat kryesore kohore, vendore dhe rrethimore të këtyre ngjarjeve. Më pas këto raportime nuk thellohen as në investigimin e shkaqeve dhe as në analizën e tyre. Një gazetari e mirë bën edhe analizën e asaj që ka ndodhur, natyrisht duke e ruajtur analizën në kufijtë e mundshëm të objektivitetit.

Deri tani dhuna në familje nuk është shndërruar në pjesë të debatit publik. Në gazeta bëhen me dhjetëra analiza, komente apo opinione në ditë, por rrallëherë gjen ndonjë prej tyre që t'i kushtohet dhunës në familje. Në televizione ka me dhjetëra emisione debati por në këto emisione gjen shumë pak raste të debatit publik për dhunën në familje. Edhe në rastin kur problematika e dhunës në familje gjen pak hapësirë në debatin radio-televiziv apo në atë të shtypit e shkruar, nismëtarët dhe nxitësit e këtij debati janë kryesisht organizatat dhe aktivistët e

çështjeve gjinore, që me shumë vështirësi arrijnë t'i bëjnë problemet e dhunës në familje probleme të debatit mediatic. Mungesa e debatit në fushën mediatike reflektohet më pas në mungesën e debatit publik për këto çështje, si dhe të atij politik.

Nga raportimet vihet re se gazetarët e kronikës së zezë kanë shumë pak formim profesional për raportimin e dhunës në familje. Tashmë ka ardhur koha që si pjesë e formimit profesional të gazetarit të mos konsiderohen vetëm aftësitë profesionale të gazetarit në mbledhjen e informacionit në terren dhe në shkrimin e lajmit por edhe njohuri më të thelluara që kanë të bëjnë me dhunën në familje. Shpeshherë ata konsiderojnë si shprehje të dhunës në familje vetëm dhunën fizike që ushtrohet ndaj pjesëtarëve të familjes ose rastet e abuzimeve seksuale ndaj pjesëtarëve të familjes ndërkohë që nuk trajtohen fare rastet e ushtrimit të dhunës psikologjike apo nuk trajtohen kushtet diskriminuese të grave në familjen shqiptare.

Në shumë raste, gazetarët janë pjesë e mentalitetit të përgjithshëm shoqëror që i konsideron rastet e shumëllojshme të dhunës në familje si pjesë të privacisë familjare dhe si të tilla nuk duhen raportuar për publikun. Në jo pak raste ata janë të ndikuar nga shoqëria tradicionale shqiptare dhe kjo vihet re në rastin kur gjatë prononcimeve të tyre në disa shkrime u njohin meshkujve disa “të drejta” që ua njuh shoqëria tradicionale shqiptare. Mes këtyre të drejtave, u njohin të drejtën për të ushtruar dhunë mbi anëtarët e tjerë të familjes, kryesisht ndaj gruas, si dhe “të drejtën” për t'u imponuar anëtarëve të tjerë të familjes pikëpamjet dhe zgjedhjet e tyre jetësore apo “të drejtën” për të përcaktuar marrëdhëniet shoqërore të anëtarëve të tjerë të familjes kryesisht të vajzave. Kur para një viti babai i një vajze në Laprakë vrau vajzën e vet sepse dashuronte një tjetër, një pjesë e shtypit e shpjegonte krimin e prindit me “të drejtën” e babait për t'i kërkuar llogari vajzës së vet për marrëdhëniet e saj dashurore.

Problematik paraqitet sidomos raportimi i trafikut të qenieve

njerëzore viktime kryesore të të cilit janë femrat. Pjesa më e madhe e këtyre shkrimeve përdorin një gjuhë fyese ndaj viktimave të këtij trafiku. Mediat janë të pandjeshme sidomos mediat ndaj femrave të trafikuar nga vendet e tjera si Moldavia, Bullgaria, Rumania apo vende të tjera të Lindjes. Raportet për këto raste por edhe për rastet e trafikut me femrat shqiptare janë të përcipta, të mbështetura vetëm në raportet e policisë dhe shpeshherë kanë një qëndrim fyes ndaj viktimave të këtij trafiku. Në shkrime të tilla bëhet më shumë kujdes për të fshehur emrat dhe identitetin e përgjegjësve të këtij trafiku që në shumicën e rasteve janë shqiptarë, sesa të viktimave të tij.

Pavarësisht kësaj problematike, media shqiptare ka bërë një progres të konsiderueshëm profesional dhe etik krahasuar me disa vite më parë. Në disa media, mbulimi i rasteve të dhunës në familje ka filluar të trajtohet më tepër si pjesë e rubrikave sociale se sa si pjesë e kronikës së zezë. Kjo natyrisht do të thotë - trajtim më i thelluar i këtyre rasteve dhe analizë më e thellë e shkaqeve dhe pasojave të dhunës në familje. Një prirje pozitive është edhe prirja për të tërhequr më shumë mendimin e specialistëve në analizën e këtyre rasteve. Kjo mundëson edhe vetëdijësimin e publikut.

Më në fund duhet kuptuar se trajtimi i drejtë i dhunës në familje ndikon në përmirësimin e vazhdueshëm të jetës së komunitetit, në krijimin e një klime jetese normale për të gjithë anëtarët e tij, si dhe në përmirësimin e standarteve demokratike të shoqërisë.

B. Gabimet që bëhen më shpesh në raportimin e dhunës në familje në median shqiptare

Media është një nga mjetet më të fuqishme të komunikimit dhe ajo luan një rol thelbësor në reflektimin e stereotipeve dhe roleve gjinore ekzistuese. Shpesh, këto stereotipe, norma e vlera të kulturës shqiptare, padashur reflektohen dhe në

mënyrën sesi rastet e dhunës në familje pasqyrohen në mediane dhe shkruar dhe atë elektronike. Jo rrallëherë, aktet e dhunshme në familje përfundojnë në vrasje, si një ushtrim ekstrem i pushtetit dhe kontrollit mbi bashkëshortët apo anëtarët e tjerë të familjes. Nuk është e pazakontë që përfaqësuesit e medias të dëgjojnë se abuzuesi ishte “një punëtor model”, apo fqinjët të thonë se ishte “një person i dashur”, pasi *dhunuesit shpesh i tregojnë botës fytyrën tjetër, të ndryshme nga ajo që u shfaqin viktimave të tyre.*

Në vitin 2003 në studimin “Ndjeshmëria e medias së shkruar ndaj çështjeve gjinore në Shqipëri” konstatohet se, ekziston një tendencë për ta kufizuar shpjegimin e dhunës në familje vetëm në problemet ekonomike dhe periudhën e tranzicionit. Sipas studimit, ajo që vihet re rëndom në media është fajësia e grave të dhunuara duke i konsideruar si shkaktare apo nxitëse. Një pjesë e mirë e artikujve nuk e shohin dhunën në familje si shkelje të të drejtave të njeriut, duke e paraqitur vetëm si lajm sensacional pa u përqendruar në shkaqet e vërteta të problemit dhe pasojave të tij. Në pjesën më të madhe të rasteve, fokusi i artikujve është tek viktimat dhe kërkohet të gjendet lidhja ndërmjet sjelljes së viktimës dhe reagimet e abuzuesit, i cili është në kushte të rënda psikike apo është stresuar për shkak të vështirësive ekonomike.

Pas monitorimit të disa gazetave të përditshme nga Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim (Gazeta Koha Jonë, Gazeta Shqip, Gazeta Panorama, Gazeta Republika, Gazeta Shqiptare, Gazeta Sot) nga data 1 Janar deri më 10 Tetor 2007, rezultoi se këto probleme të konstatuara në vitin 2003, qëndrojnë akoma.

Më poshtë do të përmendim gabimet që hasen më shpesh në raportimin e dhunës

- b.1.** Mediat shqiptare në pjesën më të madhe të tyre mbizotërohen nga lajmet politike dhe nga informacionet argëtuese. Kjo ka bërë që ato t'i kushtojnë shumë pak hapësirë informacioneve që kanë

të bëjnë me dhunën në familje. Sipas një monitorimi të kryer nga Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim", lajmet për dhunën në familje zënë vetëm 0.3% të totalit të shkrimeve të botuara në gazetë. Dhuna në familje shfaqet në faqet e shtypit vetëm kur ka viktimë të kësaj dhune. Ndërkohë që ajo është para së gjithash një problem social i përhershëm dhe duhet trajtuar si i tillë.

- b.2.** Raportimi i dhunës në familje bëhet në mënyrë sipërfaqësore. Zakonisht lajmet për dhunën në familje përqendrohen tek rrethanat dhe mjetet e krimit por jo tek shkaqet. Një raportim i plotë dhe profesional do të thotë edhe analizë e shkaqeve dhe pasojave.
- b.3.** Raportimi i dhunës në familje është shpeshherë një përshkrim i detajuar i skenave të përdhunimit dhe disa imtësive që dëmtojnë jo vetëm viktimën, por edhe publikun. Në njëfarë mënyrë, gazetari përsërit në mënyrë verbale *'një ridhunim të viktimës'*. Ja një shembull: *"Nën kërcënimin e të bërtiturave ai e ka hipur të motrën në një kodër që ndodhej pranë liqenit ku ndodheshin dhe disa tunele dhe bunkerë... Pasi janë futur brenda, ai e ka keqtrajtuar barbarisht, ka arritur që ta zhveshë dhe më pas ka kryer marrëdhënie seksuale me të duke ushtruar dhunë barbarisht"...*
- b.4.** Në rastet e krimeve të shkaktuara nga dhuna në familje shkrimet apo shërbimet radiotelevizive përqendrohen tek mjetet dhe detajet e kryerjes së krimit, gjë që ka ndikim psikologjik negativ si tek viktimat e krimit ashtu edhe tek publiku i identifikuar me viktimën. Ja një shembull: *"Pasi u grindën në kuzhinë, burri mori thikën dhe goditi gruan disa herë në gjoks dhe fytyrë. Pas pak minutash gruaja vdiq duke dhënë shpirt në një pellg gjaku shkaktuar nga plagët e shumta"*.
- b.5.** Në shumë raste, gjatë raportimit të rasteve të dhunës në familje, të abuzimeve seksuale apo të rasteve të trafikimit, autorët e shkrimeve e zbulojnë identitetin

e viktimave pa marrë lejen e këtyre të fundit. Edhe në rastin kur përdoren iniciale, përshkrimi bëhet në mënyrë të tillë që e bën lehtësisht të identifikueshëm viktimën

- b.6.** Titujt e shkrimeve për dhunën në familje janë hiperbolikë dhe synojnë më tepër të prekin emocionalisht lexuesin se sa të japin thelbin e asaj që ka ndodhur. Tituj të tillë si *“burri vret gruan me sëpatë”*, *“masakron të shoqen nga xhelozia”*, e të tjerë, janë të shpeshtë në lajmet për dhunën në familje.
- b.7.** Në shumë raste gazetarët e konsiderojnë dhunën në familje si një fatalitet, të cilit gratë duhet t’i nënshtrohen. Raportimi i motiveve të vrasjes shpeshherë pranohet në mënyrë të tërthortë si pretekst edhe nga autorët e shkrimeve. Në shumë shkrime, xhelozia, hakmarrja apo tradhtia e gruas komentohen si *“motive”* të autorëve të dhunës pa u kundërshtuar nga autorët e shkrimit.
- b.8.** Gjuha e përdorur në raportimin e rasteve të dhunës është joetike. Jo rrallëherë ndeshen formulime të tilla si *“vret motrën prostitutë”*, *“policia kap 4 prostitutë”*, *“nëna prostitutë”*, etj.
- b.9.** Në shumë shkrime nuk del i qartë pozicioni i atij që e ushtron dhunën dhe viktimës së kësaj dhune. Ka një prirje për fshehjen e autorëve të dhunës në familje ndërkohë që në shumë raste disa prej tyre përbëjnë një rrezik edhe për persona të tjerë.
- b.10.** Në mediat elektronike dhe të shkruara, kemi një varfëri zhanresh në informimin rreth rasteve të dhunës ku vihet re *mbizotërimi i lajmit*. Ndërkohë që historia e veçantë, portreti, intervista, përdoren shumë pak për informimin e publikut për këto raste.
- b.11.** Titujt e shumë shkrimeve nuk përputhen me përmbajtjen e këtyre shkrimeve. Nevoja për të tërhequr

vëmendjen e publikut bën që titujt të jenë bombastikë, por pa lidhje me atë që ka ndodhur realisht.

- b.12.** Shumë shkrime për dhunën në familje janë të pasakta, për sa i përket elementëve kryesorë informativë të lajmit. Gazetarët jo përherë arrijnë të vihen në kontakt me personazhet kryesore të ngjarjeve, kështu që e ndërtojnë lajmin duke u mbështetur në të dhëna të paverifikuara të mbledhura nga rrethi familjar apo shoqëror pranë personazheve të dhunës në familje. Si pasojë e kësaj, në jo pak raste raportimet për dhunën në familje legjitimojnë thashethemnajën që qarkullon për ngjarjen.
- b.13.** Në shumë raste gazetarët kalojnë nga rastet e veçanta në përgjithësime të tipit *“gruaja është më e dobët se burri”*, apo *“gratë detyrohen t’i nënshtrohen dhunës së burrave”*. Kjo është e dëmshme pasi, e para nuk shpreh realitetin dhe e dyta ndikon negativisht tek publiku.
- b.14.** Raportimet e rasteve të dhunës në familje shpeshherë nuk përfshijnë dhunën ndaj fëmijëve. Kjo sepse në shumë raste dhuna ndaj fëmijëve konsiderohet si një e drejtë legjitime e prindërve. Praktikisht, mediat shqiptare nuk kanë një metodikë të raportimit të dhunës ndaj fëmijëve.
- b.15.** Edhe në rastet kur raportohet për dhunën ndaj fëmijëve, shpeshherë nuk respektohen parimet etike të intervistimit të tyre dhe normat ligjore. Një fëmijë duhet të përgjigjet vazhdimisht dhe vetëm në prani të personit që e ka nën kujdestari.
- b.16.** Përgjithësisht kur flasim për dhunën në familje, kemi parasysh faktin se dhuna ushtrohet vetëm në një drejtim dhe se kjo është kryesisht dhunë e burrave ndaj grave. Në të vërtetë ekziston edhe dhuna e grave ndaj burrave.
- b.17.** Pranimi i stereotipit të dhunës së burrave ndaj grave

bën që edhe kur raportohet për raste të dhunës së grave ndaj burrave, kjo konsiderohet si një histori e jashtëzakonshme, argëtuese dhe e denjë për barcaleta dhe jo si një ngjarje serioze dhe e dëmshme.

Shembuj...

Tituj si *'Qëllon gruan me sqepar: Më fyente në sytë e të tjerëve'*, (*Gazeta Panorama, 09/02/2007*) që justifikojnë sjelljen e dhunshme të bashkëshortit, jo vetëm nuk analizojnë problemin e vërtetë, por krijojnë një farë natyrshmërie duke legjitimuar aktet e dhunës dhe sigurisht duke bërë shkaktare gruan për sjelljen e burrit.

Artikulli *"Rrëmben e lidh gruan në sy të të dashurës"* (*Gazeta Panorama, 20/03/2007*), na jep mesazhin se e dashura është shkaktarja dhe arsyeja për të cilën burri bën një veprim të tillë, duke përforcuar idenë e gruas si mollë sherri.

Artikujt me tituj 'impresionues' janë të shumtë, ja një tjetër shembull *"Kur dashuria tregohet me sopatë"* (*Koha Jonë, 12/06/2007*) - E paska vrarë sepse e ka dashur shumë. Ajo duhet të bërë ndonjë gjë që e ka lënduar aq shumë sa e ka bërë të shoqin të humbë kontrollin.

Aleanca Gjinore për Zhvillim, 2007 *'Vetëm ligjet nuk mund ta ndalojnë dhunën, kurse ne të gjithë, Po!'* Broshurë informative, Tiranë.

C. Ndikimi i mediave.

Mediat, funksioni parësor i të cilave është informimi i publikut, janë instrumentet më efikase për ta përcjellë informacionin që ka të bëjë me dhunën në familje tek publiku. Vetëm nëpërmjet tyre, publiku mund të marrë informacionin e mjaftueshëm për

atë që ndodh në familjen shqiptare. Deri para disa vitesh, problemi i dhunës në familje është konsideruar si një problem që nuk duhet të dalë jashtë mureve të shtëpisë. Por më vonë me vetëdijësimin e mediave për rëndësinë e transparencës së një problematike të tillë si dhe me ngulmimin sidomos të organizatave që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të grave, mediat e kanë bërë dhunën në familje pjesë të informacionit të tyre. Tashmë shoqëria shqiptare informohet në mënyrë të vazhdueshme rast pas rasti për ngjarjet që kanë të bëjnë me dhunën në familje.

Kjo masë e madhe informacioni u krijon mundësinë aktorëve politikë dhe shoqërorë që të kuptojnë përmasat e dhunës në familje. Kjo bën të mundur më pas, edhe përpjekjet për ta ndryshuar situatën e dhunës në familje. Dihet se një shoqëri e informuar është edhe një shoqëri që vepron. Nëse sot vëmë re një rritje të ndjeshmërisë për dhunën në familje, kjo ndodh edhe (kryesisht) për shkak të masës së madhe të informacionit që qarkullojnë mediat për këtë plagë shoqërore. Por nëse vëmë re se kjo ndjeshmëri është ende e pamjaftueshme, kjo ndodh edhe sepse informimi i publikut nga mediat nuk është ende në nivelin e duhur profesional. Përmirësimi i nivelit të informimit rrit nivelin e ndjeshmërisë së publikut dhe njëkohësisht edhe të veprimit të aktorëve shoqërorë të lidhur me këtë çështje. Një shoqëri e informuar është njëkohësisht edhe një shoqëri që vepron.

Dihet tashmë se mediat përcaktojnë axhendën politike dhe publike të një shoqërie. Duke informuar për rastet e dhunës në familje dhe duke nxitur debatin për këtë dhunë, mediat i detyrojnë aktorët politikë dhe publikë që ta përfshijnë dhunën në familje në axhendën e ditës. Aktorët politikë dhe publikë nuk mund të mos e trajtojnë dhe nuk mund të mos përfshihen në zgjidhjen e një problemi për të cilin raportohet vazhdimisht në media. Këta aktorë vihen me këtë rast para tre presioneve:

- a. mediave
- b. publikut

c. personave të prekur nga dhuna në familje.

Një presion i tillë shërben për ndërmarrjen e masave për zgjidhjen e problemit të dhunës në familje. Sa më shumë raste të dhunës në familje të publikohen në media, dhe sa më me ngadalësi të veprojnë aktorët politikë dhe shoqërorë për zgjidhjen e problemit të dhunës në familje, aq më i madh bëhet presioni i publikut.

Mediat kanë një rol shumë të madh edhe në edukimin e publikut. Ato ndikojnë në krijimin e modeleve të sjelljes së publikut dhe në mentalitetin e tij. Mediat shqiptare nuk e vlerësojnë shumë këtë rol ose më saktë nuk e kanë ende vetëdijen e një misioni të tillë. Kjo bën që shpeshherë raportimi për dhunën në familje, nën pretekstin e objektivitetit, t'i shmanget qëndrimit ndaj kësaj dhune. Këtu nuk bëhet fjalë për të deformuar lajmin nga pikëpamja profesionale dhe as për shndërrimin e lajmeve në leksione moralizuese. Por që impakti i mediave të jetë më i madh, është e domosdoshme që raportet për dhunën në familje të shoqërohen me komente, me reagime të aktorëve të ndryshëm politikë dhe publikë, me reagime të qytetarëve si dhe me mendimet e specialistëve. Vetëm kështu krijohet kuadri i plotë i një raportimi informues dhe edukues njëherësh.

Duke raportuar për dhunën në familje, mediat ushtrojnë presion tek autorët e dhunës sepse ata e informojnë publikun për veprimtarinë e tyre dhe kjo bën që aktet e tyre të vihen para gjykimit të tij. Natyrisht, një gjë e tillë bën që autorët potencialë të akteve të dhunës të jenë më pak komodë dhe më të frenuar në ushtrimin e dhunës. Mediat duhet të jenë pa asnjë hezitim në krahu të viktimave, sepse kështu ata përmbushin një funksion shoqëror të rëndësishëm. Ky pozicionim realizohet vetëm nga media të emancipuara, që synojnë të kontribuojnë për ndërtimin e një shoqërie moderne dhe demokratike të çliruar nga dhuna. Shpeshherë, ky mision shoqëror i mediave pengohet nga ekzistenca e një mentaliteti tradicional tek komunitetet e gazetarëve. Në jo pak raste ka gazetarë, opinionistë dhe drejtues

të mediave që kanë të njëjtin mentalitet mbizotërues maskulist që ka edhe pjesa tjetër e shoqërisë. Ky mentalitet shprehet në forma të ndryshme, që nga qëndrimi që mbajnë ndaj grave në rastet e raportimit të ngjarjeve të dhunës, e deri tek qëndrimet e hapura të tipit maskulist. Një komunitet gazetarësh i emancipuar, jo vetëm që raporton në mënyrë më profesionale për problemet e dhunës në familje, por edhe bëhet pjesë e luftës dhe qëndrimit shoqëror kundër kësaj dhune, duke ndihmuar kështu në rritjen e presionit të shoqërisë ndaj autorëve të kësaj dhune dhe ndëshkimit të tyre.

Ndërkohë që i lexon titujt sensacionalë të gazetave, reagimi që shkaktojnë shumë herë është drithërues. Nuk mund të na kalojë para sysh një titull si *"Mbyll hallet me një plumb"*, (Koha jonë, 05/09/2007), dhe të mos na ngrejë disa pikëpyetje mbi ndikimin e mundshëm tek lexuesit. Mjafton të imagjinojmë momentin kur një gazetë me këtë titull gjigant dhe tronditës, bie në duart e një gruaje që është viktimë e dhunës së vazhdueshme nga bashkëshorti apo familja e saj. Në qoftë se ne si lexues të paprekur nga një problem i tillë do mjaftoheshim me një lexim të shpejtë të artikullit, ajo grua që vuan çdo ditë nga dhuna, aty do gjente përgjigjen e problemit të saj. Pra, dhe ajo si bashkëvuajtësja e saj, do merrte vendimin fatal (që fundja i kishte shkuar në mendje por kurrë s'kishte guxuar ta bënte), sepse kështu do mbyllte të gjitha hallet e saj!!!


Aleanca Gjinore për Zhvillim, 2007 *'Vetëm ligjet nuk mund ta ndalojnë dhunën, kurse ne të gjithë, Po!'* Broshurë informative, Tiranë.

Roli informues i mediave nënkupton edhe faktin se ata realizojnë njëherësh edhe integrimin e individit në shoqëri. Duke e informuar individin, mediat e bëjnë atë pjesë të shoqërisë. Kjo vlen edhe për viktimat e dhunës në familje. Shpeshherë ekziston opinioni i gabuar se informimi i shoqërisë për dhunën në familje, mund të çojë drejt izolimit të viktimave të saj dhe drejt krijimit të një pozicioni të pafavorshëm shoqëror të tyre. Në fakt, është krejt e kundërta. Nëpërmjet mediave, viktimat gjejnë shtigje komunikimi me shoqërinë dhe kështu natyrshëm krijohet një atmosferë bashkëpunimi rreth tyre. Kjo atmosferë krijon mundësi për tejkalimin e gjendjes së dhunës dhe përfshirjen normale të viktimave në jetën shoqërore.

Rrethi i Influencës

Duke e parë median nëpërmjet lenteve gjinore, kuptojmë se si media i trajton ndryshe burrat dhe gratë dhe nga ana tjetër burrat dhe gratë tregojnë ndjeshmëri të ndryshme ndaj mesazheve të medias. Kur bëjmë një analizë të këtyre mesazheve nga një perspektive gjinore, vëmë re se si këndvështrimet tradicionale ndikojnë formimin e mesazheve që përcjell media. Me kalimin e kohës, po këto mesazhe mediatike ndikojnë mënyrën se si gratë dhe burrat vihen në marrëdhënie me njëri tjetrin. Ky proces kthehet në **një rreth influence** shumë efikas.¹⁰

¹⁰ Women's Media Watch 1998. *'Whose Perspective – a Guide to Tender Sensitive Analysis of the Media'* Training Manual, Jamaica.



problemeve të tilla të mprehta si dhuna në familje është rritur në mënyrë të vazhdueshme. Megjithatë në jo pak raste, mediat jo vetëm që nuk e luajnë si duhet rolin e tyre por luajnë një rol negativ. Kjo lidhet me nivelin profesional dhe etik të mediave shqiptare. Mediat shqiptare janë relativisht të reja dhe me mjaft probleme. Në shumë raste ato janë shumë larg nevojave dhe interesave të publikut. Përqendrimi vetëm në ngjarjet politike, ka ndikuar në lënien pas dore të shumë problemeve të mprehta të shoqërisë ku bën pjesë edhe dhuna në familje. Profesionalizëm nuk do të thotë vetëm të raportosh me objektivitet ngjarjet, por ta sjellësh realitetin shoqëror sa më të plotë para publikut. Këtë mediat jo përherë e realizojnë si duhet dhe dëshmi e kësaj është edhe niveli jo i kënaqshëm i raportimit të dhunës në familje.

4. UDHËZIME MBI RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE

A. Argumente mbi rëndësinë e një perspektive gjinore në pozicionimin e medias

Sipas shumë studimeve në nivel global rezulton se gratë janë të nën-përfaqësuar dhe të keq-përfaqësuar në pothuaj të gjithë përmbajtjet dhe imazhet mediatike. Në përgjithësi ato prezantohen në sferën private, kryesisht në familje dhe rrallëherë prezantohen si racionale, aktive apo vendim-marrëse. Sigurisht hasen edhe modele pozitive të cilat duke qenë se janë më të pakta, mbeten pothuaj përjashtime.

Ka disa argumente që mbështesin rëndësinë e një perspektive gjinore në mënyrën se si media pozicionohet. Le të përmendim disa prej tyre:¹¹

- Argumente **në fushën e të drejtave të njeriut**: Eliminimi i stereotipeve gjinore është në fakt një detyrim si pjesë e të drejtave të njeriut: Artikulli 5 i CEDAW, kërkon që shtetet që e kanë ratifikuar këtë konventë (përfshi këtu edhe Shqipëria, në vitin 1993) duhet të ndërmarrin masa të nevojshme për të eliminuar paragjykimet dhe praktikat e bazuara në rolet e stereotipizuara të grave dhe burrave.
- Argumente **të besueshmërisë**: Nëse institucionet mediatike nuk e promovojnë barazinë gjinore (p.sh. nuk e adaptojnë

¹¹ Neimans, A. 2006 Gender mainstreaming in practice: a handbook. UNDP, Regional Bureau for Europe and CIS, fq. 80-82.

këtë si një politikë), mund të thuhet se ato në fakt promovojnë diskriminimin gjinor, Institucionet mediatike që janë transparente për politikat e tyre janë më të besueshme.

- Argumente **të eficientës**: Barazia gjinore është në fakt një kusht kryesor për një zhvillim të plotë ekonomik edhe social të një kombi dhe media mund të jetë një mjet shumë efikas në fuqizimin e barazisë gjinore, për promovimin e zhvillimit ekonomik edhe social.
- Argumenti i **aleancave**: Për shtetet që kërkojnë anëtarësimin në Komunitetin Europian, është e rëndësishme të nënvizohet se një nga objektivat e Komisionit të Promovimit të Barazisë Gjinore, është të promovojë ndryshim të roleve dhe stereotipeve gjinore. Edhe këtu media është përmendur si një fushë prioritare.
- Argumenti i **Reaksionit Zinxhir**: Meqë media sjell çështje të ndryshme në vëmendje të opinionit publik dhe shpesh vendos parametra për debatet publike, media mund të jetë një mjet i dobishëm në zgjidhjen e një sërë problemesh gjinore, në një numër ta madh sektorësh dhe në hartimin e politikave. Prandaj është thelbësore sigurimi i një perspektive gjinore në mënyrën se si media është pozicionuar.

Bashkimi Europian kërkon më pak stereotipizime gjinore në marketing

Më datë 3 Shtator 2008, pjesëtarët e Parlamentit Europian aprovuan *raportin për efektet që ka marketingu në arritjen e barazisë gjinore dhe në stereotipizimet gjinore*.

Raporti i kërkon mediave të përdorë shembuj më të mirë lidhur me përkatësinë gjinore dhe thekson se shumë stereotipizime gjinore në reklama të ndryshme, kanë si qëllim fitimin financiar. Gjithashtu raporti mban qëndrim rreth portretizimit që i bëhet ‘trupit perfekt’, pasi kjo sjell ulje të vetëvlerësimit si tek burrat dhe tek gratë.

Rekomandimet në raport përfshijnë *përdorimin e imazheve trupore më realiste për gratë, si dhe më shumë ndërgjegjësime institucionale ndaj fyerjeve seksiste që i drejtohen burrave dhe grave*. Në nivel politikash, ky raport i kërkon vendeve të BE-së të monitorojnë se si portretizohet përkatësia gjinore në marketing, si dhe i kërkon institucioneve të BE-së të monitorojnë progresin e ligjeve ekzistuese mbi diskriminimin seksual.

Ky raport i KE-së tregon se sfida për zhdukjen e stereotipeve gjinore, nuk mund të përballohet pa adresimin e rolit madhor të medias.

B. Për një etikë të raportimit të dhunës në familje – Imazhe të dhunës në artikullin ose reportazhin tuaj

Fotot ilustruese dhe sekuencat filmike të shkrimeve që raportojnë rastet e dhunës përbëjnë një element të rëndësishëm të raportimit. Dihet tashmë se fotot janë element i rëndësishëm informativ i lajmit, por përdorimi i tyre është një problem etik mjaft i diskutueshëm. Imazhet e dhunës ndikojnë në psikologjinë e audiencës dhe mund të shkaktojnë trauma të rënda psikologjike tek ajo. Kategoritë e publikut përfshijnë moshën nga më të ndryshmet që nga fëmijët e deri tek të moshuarit, tipa psikologjikë nga më të ndryshmit dhe individë me formim kulturor e akademik gjithashtu shumë të ndryshëm. Imazhi është lehtësisht i perceptueshëm nga të gjitha këto kategori por është njëkohësisht edhe mjaft ndikues.

Mite të gabuara rreth medias – Sfida për t'u përballuar

- Media nuk ndikon sjelljet e njerëzve sepse ata e dinë që realiteti është ndryshe
- Kush e ka shkruar mesazhin mediatik nuk ka dashur të thotë atë që kuptojmë.
- Media pasqyron realitetin ashtu siç është.
- Edhe meshkujt portretizohen gabim shumë shpesh në media.
- Përdorimi i imazheve femërore në marketing funksionon shumë mirë, pse duhet të hiqet dorë nga një gjë e tillë...
- Shtëpitë botuese dhe mediat në përgjithësi kanë të drejtë të prodhojnë çfarë të duan, ashtu siç kanë lexuesit të drejtën të lexojnë, shohin dhe dëgjojnë ç'të duan – përndryshe do të ishte një censurë.
- Gratë ja lejojnë vetë vetes që të shfrytëzohen nga mediat.

Gjatë raportimit të dhunës në familje, vihet re një përdorim krejt i pakujdesshëm i imazheve të dhunës në mediat elektronike, dhe i fotove në mediat e shkruara. Ka shumë raste kur kamera jep në mënyrë të detajuar gjurmët e dhunës së shkaktuar dhe shpeshherë pamje të tilla janë makabre. E njëjta gjë ndodh me fotot e gazetave - kamera e fotografit jep deri në imtësi gjurmët e dhunës duke përcjellë shpeshherë pamje të shpërftyruara grash.

Fokusimi në detajet e dhunës është i dëmshëm për tre arsye:

- a. rrit përmasat e dhunës duke e shtrirë atë tek publiku;
- b. krijon një gjendje terrori tek viktimat e dhunës dhe tek viktimat potenciale të dhunës të cilat nën këtë presion imazhesh të dhunshme e ndjejnë veten më të pasigurtë dhe

më të paafta për t'iu kundërvënë dhunës mashkullore;
c. ndikon negativisht tek fëmijët.

Edhe nga pikëpamja etike është i ndaluar përdorimi dhe transmetimi për publikun e gjerë i të gjitha pamjeve dhe imazheve që kanë të bëjnë me gjyftime të rënda fizike të njerëzve.

Publikimi i imazheve të dhunës në familje nuk ruan privacinë e viktimave. Shpeshherë ato identifikohen pa rekomandimin e tyre dhe kjo jo vetëm mund të verë në rrezik jetën e tyre por edhe mund të ndikojë në marrëdhëniet e tyre shoqërore dhe familjare. Fotografimi i fëmijëve të dhunuar është rreptësisht i ndaluar, por në disa shërbime televizive apo në disa fotografi gjejmë të identifikuar fëmijë të dhunuar.

RAPORTIMI I RASTEVE TË DHUNËS NË MEDIA KËRKON KUJDES TË VEÇANTË

- Dhuna në familje duhet të nënvizohet si dhunim i të drejtave themelore të njeriut.
- Njohja e cilësimi i dhunës duhet trajtuar si një krim i ngjashëm me krimet e tjera të rënda.
- Media ka funksion të rëndësishëm në edukimin publik, prandaj në raportimet e dhunës duhet të sfidohen mitet për dhunën ndaj gruas dhe dhunës në familje.

Aleanca Gjimore për Zhvillim, 2007 'çfarë duhet të dimë rreth dhunës në familje', Broshurë informative për të rinjtë, Tiranë.

Në shtypin e shkruar dhe në mediat elektronike në mungesë të fotove apo të pamjeve filmike të viktimës së një akti dhune shfaqen foto apo pamje filmike të rasteve të mëparshme dhe nëpërmjet tyre ilustron vizivisht një ngjarje aktuale. Këto

pamje apo foto përdoren në mënyrë sistematike duke shkelur kështu jo vetëm standartet profesionale dhe etike por duke bërë edhe shkelje ligjore.

Problemi i transmetimit dhe publikimit të dhunës në familje bëhet edhe më i mprehtë në rastin e internetit. Nëpërmjet internetit çdo individ mund të bëhet një prodhues dhe transmetues i pamjeve të dhunshme. Ky problem bëhet më i mprehtë për faktin se në Shqipëri nuk ekziston ende një bazë ligjore për mënyrën e përdorimit të internetit ashtu sikurse nuk ekziston një institucion mbikëqyrës që të vendosë sanksione ndaj abuzimeve të mundshme...

C. Përdorni burime të besueshme të informacionit për artikullin ose reportazhin tuaj.

- c.1.** Raportimi i rasteve të dhunës në familje, varet shumë nga mënyra se si gazetari i shfrytëzon burimet. Cëtimi i paanshëm i burimeve e rrit objektivitetin e lajmit. Gazetari duhet t'u referohet burimeve të të dy palëve në konflikt si dhe burimeve policore.
- c.2.** Burimet njerëzore për shkak të konfliktit janë burime që mund ta tregojnë ngjarjen sipas një këndvështrimi të caktuar, për shkak të emocioneve dhe në jo pak raste edhe ta manipulojnë atë. Në pjesën më të madhe të rasteve janë autorët e dhunës ata që janë më shumë të interesuar për ta manipuluar informacionin. Gazetarët duhet t'i konfirmojnë informacionet e burimeve edhe në burime të tjera.
- c.3.** Burimet fizike (dokumentat), janë më pak të manipulueshme se burimet njerëzore. Një letër në formë ankese që viktimi ka dërguar në rajonin e policisë, një e-mail që ajo i ka dërguar një shoqeje, një letër që u ka dërguar prindërve mund të zbulojë shpeshherë shumë më tepër se sa dëshmitarët realë.

- c.4.**Në shumicën e rasteve dëshmitë e viktimave janë të deformuara për shkak të presionit që ushtrohet nga autorët e dhunës mbi to. Intervistimi i drejtpërdrejtë nuk është në të gjitha rastet rezultativ. Shpeshherë duhen gjetur mënyra jo të drejtpërdrejta për marrjen e informacionit.
- c.5.**Viktimat kanë gjithmonë nevojë për mbrojtje ligjore dhe morale që të shërbejnë si burime informacioni. Mbrojtja e tyre është një detyrim jo vetëm ligjor por edhe moral i shtypit.
- c.6.**Viktimat u përkasin kategorive shoqërore të ndryshme dhe kanë nivele kullore të ndryshme. Disa prej tyre nuk kanë aftësi për t'u shprehur kështu që është detyrë e gazetarëve që t'i ndihmojë ata në rrëfimin e asaj që ka ndodhur.
- c.7.**Një pyetësor i mirë e ndihmon dëshmitarin të shprehet më mirë, por në ndonjë rast e bën dëshmitarin të pohojë paragjykimet e gazetarit që reflektohen në pyetjet e tij. Lëreni dëshmitarin të shprehet, më pas drejtojuni pyetësorit.
- c.8.**Gazetari duhet ta mbrojë anonimatën e burimit në rastin kur ky burim dëshiron të mbetet anonim. Ruajtja e anonimitetit është e domosdoshme sidomos për viktimat e dhunës. Në shumë raste ato nuk duan ta tregojnë identitetin për shkak të mjedisit shoqëror, por në disa raste edhe për shkak se ndjehen të kërcënuara. Në jo pak raste, shfaqja e identitetit mund të verë në rrezik jetën e burimit.
- c.9.**Burimet zyrtare nuk janë përherë të sigurta. Policia shpesh krijon pista të gabuara për ngjarjet. Edhe përfundimet e gjykatave nuk janë përherë të drejta. Gazetarët duhet të bëjnë investigimet e tyre dhe t'i konfrontojnë të dhënat e tyre me të dhënat zyrtare.
- c.10.**Kur merren si burime dëshmitarë dytësorë të

pranishëm në ngjarje, ata kanë shpeshherë prirjen për ta tjetërsuar ngjarjen. Arsytet janë të ndryshme dhe lidhen me statusin e tyre në raport me palët në konflikt, me aftësinë e tyre për ta kuptuar dhe shpjeguar realisht atë që ka ndodhur, me distancën fizike nga ngjarja, etj. Ka individë që janë të prirur për të folur për ngjarje në të cilat nuk kanë marrë pjesë. Është detyrë e gazetarit që t'i zbulojë tipa të tillë dhe të mos i pranojë si dëshmitarë.

- c.11.** Gazetarët duhen të jenë të saktë në citimin e deklaramëve të dëshmitarëve. Një raportim i saktë nënkupton edhe rikonfirmimin e informacioneve të dhëna nga burimet para botimit të shkrimit. Kjo shpeshherë sjell informacione të reja për ngjarjen.
- c.12.** Gazetarët nuk duhet të ngatërrojnë punën e tyre me atë të hetuesit. Informacioni i marrë nga burimet duhet të përdoret vetëm për informimin e publikut dhe nuk duhet t'u serviret gjykatave.
- c.13.** Gazetari duhet ta vendosë ngjarjen në një sfond sa më të gjerë. Burimet më të mira për krijimin e sfondit duhen gjetur në rrethin familjar dhe shoqëror të viktimave dhe të autorëve të dhunës në familje. Këto informacione shërbejnë për të arritur tek shkaqet e thella të dhunës.

D. Si të ndërtohet një mesazh për raportimin e dhunës në familje

Gazetarët kanë në dorë një mjet të fuqishëm, gjuhën që i bën ata të kenë rol ndikues në pozicionimin ndaj një ngjarjeje të ndodhur. Siç pranon Mëniku, (2005:80), gazetarët kanë mundësinë të përzgjedhin vetë terminologjinë që përdorin në shkrimet e tyre, për pasojë ta emërtojnë fajtor dhunuesin, ose të jenë në anën e të dhunuarit/ës.

i. Ndryshimi në perceptimin e kulturës së pranimit që rrethon dhunën ndaj grave

Wood (2005:233) pranon se sot në media tre janë temat që predominojnë kur flitet për modelet e paraqitjes së gjinisë në to. I pari, sipas të cilit gratë dhe minoritetet janë të papërfaqësuar, i dyti, gratë dhe burrat janë të portretizuar sipas stereotipave, përfaqësuese të pikëpamjeve konvencionale të gjinisë, dhe së treti përshkrimi i marrëdhënieve mes burrit e gruas thekson rolet tradicionale të pushtetit të pabarabartë mes burrit dhe gruas. Sipas këtij kategorizimi, në raportim është e mundshme (madje e pritshme!) që dhe gazetari të bjerë në këtë situatë. Ajo që do ta ndihmonte për të sfiduar skemën, do të ishte përpjekja për të dalë jashtë saj, duke kërkuar mendim nga një sy i jashtëm, qoftë dhe koleg, për të marrë një mendim neutral mbi këtë raportim. Gjithashtu, në raportimin e dhunës në familje, gazetari udhëhiqet nga parimet bazë të mbledhjes dhe editimit të lajmit apo reportazhit: parimi i saktësisë, i besnikërisë dhe i paraqitjes së balancuar¹². Kjo do të kuptojë ruajtjen e një principi neutraliteti në raportimin e lajmit, por që gjithsesi do të ruante fokusin në ngritjen e problemit social duke trajtuar një rast individual.

ii. Si raportohen dhunuesit? Etiketimi

Ka një prirje të dalluar në media që i portretizon burrat si agresivë, të pavarur, dhe në kontroll të situatave (Wood, 235). Kjo prirje duket sikur legjitimon dhe veprimet që do të lidhen me demonstrimin e këtyre tipareve, kur në të vërtetë, ushtrimi i dhunës është një dobësi për të reaguar në mënyrë tjetër dhe për të gjetur me forcën e arsyes përgjigjen për problemin që ka shkaktuar këtë pasojë. Shkaqet, shpesh, janë dhe më të thella në të vërtetë.

¹² WACC, Taking sides 'Mission Possible': A Gender and Media Advocacy Toolkit, <http://www.peacewomen.org/un/ngoadvocacy/1325Tools> parë për herë të fundit në shtator 2008

iii. Si raportohen viktimat?

Viktimat janë shpesh gratë dhe fëmijët, si pjesa më me pak pushtet në një familje tradicionale. Ato paraqiten si më të dobëta, dhe është dobësia e tyre si predispozitë që i bën ato pre të dhunës. Media ndikon në këtë rast për të formësuar pikëvështrimin se çfarë është e drejtë dhe normale në një marrëdhënie mes burrit dhe gruas (Wood:255).

iv. I jepet fund tabusë së dhunës me bazë gjinore nëpërmjet intervistimit të funksionarëve të shtetit që merren me zbatimin e ligjit, personelit mjekësor, ekspertëve, dhunuesve, të mbijetuarve apo viktimave të dhunës.

Guximi për ta trajtuar dhunën si një pjesë e një realiteti që na rrethon, kërkon para së gjithash ta demitizosh atë, duke e parë në përmasat fizike që ka dukuria – pasojat për gjithë palët e përfshira në këtë marrëdhënie të cënuar. Për pasojë, dhënia hapësirë e zërit të individit në raportimin e dhunës në media, përbën një aspekt tjetër që ndikon për ta nxjerrë dukurinë nga muret e shtëpisë, ku pushteti është me më të fortin dhe për ta bërë atë publike. Në rastet kur ngjarja është publike, audiencia është e prirur të mbajë qëndrim dhe të ndërtojnë dhe vetë një model. Siç pranon Loren Greenfield, duke qenë se të rinjtë apo dhe të rriturit, rriten në një botë të ngopur me media, ata besojnë në rëndësinë e imazhit, dhe i përdorin imazhet e medias për të ndërtuar identitetin dhe marrëdhëniet e tyre (Wood:233).

Demitizimi i tabusë së dhunës, duke ua sjellë zërin atyre që janë në kontakt me të, do t'i jepte një përmasë më të prekshme dukurisë. Dhe në këtë kontekst mjete që më mirë do të nxirrte këtë përmasë do të ishte intervista e drejtpërdrejtë me ata që janë të lidhur, si gjykatësit (ç'mendojnë për ligjin që është në fuqi sepse si praktikues ata arrijnë ta dallojnë dhe mangësitë që ai paraqet në zbatim, apo nevojën për akte nënligjore ligjore të lidhura me të), mjekët dhe personeli shëndetësor, i cili është i detyruar dhe ligjërisht të raportojë rastet e dhunës, por që

mund të jetë zëdhënës i një aspekti të ndjeshëm (cënimi fizik dhe plagët fizike, e pasojat e tyre flasin më shumë). Mbi të gjitha zëri i atyre që janë të përfshirë në të, në të dy anët e këtij procesi – ata që e ushtrojnë dhe ata që e pësojnë.

v. Edukohet publiku duke i ofruar modele alternative përkundrejt sjelljeve të dhunshme.

Jo vetëm duke ndërkshuar, por dhe duke dhënë një shembull të mirë, publiku mund të ndikohet publike – rastet positive të mbështetjes dhe ndarjes së përgjegjësive mes burrit dhe gruas në mjedisin familjar dhe social flasin dhe edukojnë me shembullin e mirë.

vi. Rritet informimi ndaj çështjeve të dhunës me bazë gjinore dhe raportimi i rasteve të dhunës me bazë gjinore nën këtë optikë.

Statistikat flasin se rastet e dhunës kanë një frekuencë të lartë. Ky fakt e bën më të domosdoshme paraqitjen dhe evidentimin e rasteve, duke dëshmuar pjesëmarrje në çështjet me rëndësi publike, të cilat në të vërtetë na përkasin të gjithëve.

Gazetarët jo vetëm raportojnë atë që ndodh, por duke qenë në këtë pozicion strategjik, ata mund të bëjnë avokaci për të adresuar problemin e dhunës në familje, si një dhunim i të drejtave bazë njerëzore dhe cënim i familjes dhe madje shoqërisë. UNIFEM prezanton konceptin e *'komunikimit për avokatinë'*, si mjet për të ndarë informacion 'të pakëtuar' në mënyra të ndryshme për t'u transmetuar duke përdorur media dhe mesazhe të ndërtuara sipas audiencave të ndryshme.¹³ Ndërtimi i mesazheve specifike nëpërmjet historive specifike, ndihmon arritjen, e për pasojë ndikimin e grupeve apo segmenteve të caktuara të audiencës, duke arritur në nxitjen e ndryshimeve jo vetëm në nivel mikro, tek individit, por dhe në nivel makro, në vendimmarrjen politike.

Çfarë gjuhe duhet të përdorim kur raportojmë dhunën në familje?

1. Zgjedhja e burimit për raportimin – si ndikon në portretizimin e dhunës.

Nëse burimi i citimit, është provuar të jetë i besueshëm, besueshmëria e artikullit apo reportazhit rritet. Në këtë mënyrë, impakti që ky shkrim sjell në mendjen e lexuesit është i shumëfishtë, dhe gjasat që ai të sjellë ndryshim janë më të larta.

2. Gjuha e përdorur nuk është paragjyquese.

Duke ruajtur neutralitetin, por duke u fokusuar në thelbin e çështjes, gazetari flet me faktin.

3. Fokusi nuk është sensacioni.

Specifika e ngjarjes, shihet si një element që ilustron idenë, por nuk është qëllim në vetvete të tregojë në mënyrë sensacionale se çfarë ka ndodhur.

4. Lufta ndaj dhunës në familje nuk është çështje e grave – burrat dhe gratë janë pjesë e zgjidhjes – komunikimi përmes sloganeve/rimarrja e temës.

Mesazhet janë të specifikuara, specifikohet segmenti i audiencës: Kur grupi i synuar janë burrat mesazhe të tilla, transmetuar nga media, mund të ndikojnë: *‘Burrat e vërtetë nuk kanë frikë nga barazia; ‘Dhuna nda gruas, një tragjedi që burrat mund ta parandalojnë’*; ose kur grupi i synuar janë gratë: *‘Gra, është e drejta juaj të kërkonit një jetë pa dhunë’*. Por, në një rast më të përgjithshëm, audiencia e gjerë është gjithashtu e arritshme me mesazhe të unifikuara: *‘Pa të drejtat e grave, nuk ka zhvillim, abuzimi s’ka arsyetim’*.¹⁴

¹³ UNIFEM, 2003. *Making a Difference, Strategic Communications to End Violence against Women*. A Toolkit from the UNIFEM Strategic Communications Workshop Series, fq. 2.

¹⁴ Përshtatur nga UNIFEM, 2003. *Making a Difference, Strategic Communications to End Violence against Women*. A Toolkit from the UNIFEM Strategic Communications Workshop Series, fq 8.

Mesazhet ripërsëriten në mënyrë të vazhdueshme, dhe riformulohen për të sjellë impakt. Përsëritja e të njëjtit mesazh siguron konsistencë të transmetimit të mesazhit, duke bërë të qartë se ata që flasin, besojnë ë atë që thonë, por njëkohësisht synojnë të sjellin ndryshim pozitiv në mjedisin social.

ANEKS

A. Mekanizmat ndërkombëtare kundër dhunës në familje

Deklaratat dhe konventat ndërkombëtare kanë dhënë një përjasje dhe kornizë ligjore për sa i përket trajtimit të dhunës në familje, pjesë e konsiderueshme e së cilës është dhuna ndaj grave. Në Konferencën e Kombeve të Bashkuara Pekin + 10 e mbajtur në vitin

2005, u kërkua nga shtetet palë që të përmbushin obligimet e tyre për sa i përket dhunës në familje.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948-1949)

Është dokumenti i parë ndërkombëtar që harton qartësisht se cilat janë të drejtat dhe detyrimet themelore të njeriut, si për burrat dhe për gratë të të gjitha kombësive, etnive, përkatësive fetare, etj. Artikulli tre i kësaj deklarate thotë: “Çdo njeri ka të drejtën për të jetuar, të qenë i/e lirë dhe i/e sigurtë”. Më tutje në artikullin 7 kjo deklaratë shprehet se “të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe të gjithë kanë të drejtë të mbrohen prej tij pa asnjë lloj diskriminimi”.

Objektivat e Mijëvjeçarit

Përhapja dhe frekuenca e dhunës në familje ndikojnë drejtpërdrejt në arritjen e Objektivit të tretë të Mijëvjeçarit që është Arritja e Barazisë Gjinore. Në mënyrë që të arrihet një

objektiv i tillë duhet të ekzistojnë ligjet mbështetëse të barazisë gjinore dhe mekanizmat implementues, monitorues dhe vlerësues. Pasi dhuna është një pengesë e vërtetë në arritjen e barazisë gjinore, shtetet palë të cilat kanë rënë dakort për përmbushjen e këtyre objektivave, duhet të marrin masat përkatëse.

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW)

Kjo konventë është adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1979 dhe shpesh referohet si ligji ndërkombëtar për të drejtat e grave. Në të përkufizohet se çfarë është diskriminimi ndaj grave si dhe përcaktohet një plan veprim për implementimin e kësaj konvente nga shtetet anëtare.

Sipas kësaj konvente *“Diskriminimi ndaj gruas nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim me bazë gjinore, që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtojë ose zhvlerësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gruaja, cilado qoftë gjendja e saj martesore, mbi bazën e barazisë midis burrit dhe gruas, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile ose në çdo fushë tjetër.”*

Shtetet anëtare dënojnë diskriminimin e gruas në të gjitha format, pranojnë të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesë një politikë me pikësynim eliminimin e diskriminimit dhe marrin përsipër: *“Të përfshijnë në kushtetutat e tyre kombëtare ose në çdo dispozitë tjetër ligjore të përshtatshme, parimin e barazisë midis burrit dhe gruas, nëse kjo nuk është bërë deri tani dhe të sigurojë përmes legjislacionit apo me mjete të tjera të përshtatshme zbatimin praktik të këtij parimi.”*¹⁵

¹⁵ Testolin, G. 2001 *“Manual mbi mekanizmit institucional për nxitjen e barazisë gjinore dhe planet për veprim”* EG 7 Këshilli i Europës, fq. 9-10.

Platforma për Veprim e Pekinit

“Platforma për Veprim e Konferencës së 4-ërt Botërore për Gruan (Pekin, 1995) përfshin “mekanizmat institucionalë për përparimin e gruas” si një nga dymbëdhjetë fushat e interesit. Platforma jep një përcaktim të mekanizmit institucional, rendit disa kushte për funksionimin efektiv të këtij mekanizmi dhe sugjeron veprimet që duhen marrë nga qeveritë. Për më tepër, Platforma siguron një mandat për mekanizmin institucional për përparimin e gruas i cili përfshin, ndër të tjera, *“hartimin, nxitjen e zbatimit, ekzekutimin, monitorimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe mobilizimin e përkrahjes për politikën që nxisin përparimin e gruas”* (paragrafi 196).

Një dekadë pas Deklaratës së Pekinit, u rishikua dhe vlerësua perioda dhjetëvjeçare e zbatimit të kësaj platforme ndër qëllimet kryesore të së cilës është shtimi i përpjekjeve (nga shtetet palë) për të luftuar dhunën ndaj grave dhe vajzave si dhe garantimi i të drejtave riprodhuese dhe seksuale. Ndërkohë që iniciativat e ndërmarra nga qeveria shqiptare kanë shumë hapësirë për përmirësime.

Barazia Gjinore dhe Bashkimi Europian

Dhuna në familje është një çështje që lidhet drejtpërdrejt me barazinë midis burrave dhe grave pasi viktimat e dhunës në familje janë kryesisht gratë. Bashkimi Europian ka dy nene në marrëveshjen e Amsterdimit (1997) të cilat adresojnë çështjet e lidhura drejtpërdrejt me barazinë gjinore. Neni 2 dhe 3 specifikon se barazia midis grave dhe burrave është një nga objektivat bazë të Bashkimit Europian ndërsa neni 13 i referohet diskriminimit që bëhet me bazë përkatësinë gjinore.

B. Përkufizime

Diskriminim

Është një sjellje e dukshme me anë të së cilës njerëzit trajtohen ndryshe dhe jo në mënyrë të favorshme, në bazë të racës, klasës, seksit apo statusit kulturor të tyre. Diskriminimi pakëson mundësitë për të patur akses mbi burimet, shërbimet shëndetësore, arsimimin, fuqizimin apo pushtetin. Në terminologjinë e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW), konsiderohet si përjashtim, pengesë apo dallim i bërë në bazë të seksit, që ka si qëllim apo efekt, mohimin e ushtrimit të barabartë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në të gjitha fushat e përpjekjeve njerëzore.

Barazia gjinore (equality)

Ky është një parim, sipas të cilit të gjitha qeniet njerëzore, pa dallim race, seksi, bindjeje fetare, niveli social-kulturor apo status politik, duhet të kenë të drejta ligjore të barabarta. Në kontekstin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, koncepti ligjor i barazisë gjinore është sanksionuar si në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të vitit 1948, ashtu edhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW) të vitit 1979. Konventa, e cila është ratifikuar nga 100 vende, deklaron qartë dhe pa ekuivokë që *“diskriminimi kundër grave dhunon parimet e barazisë së të drejtave dhe respektit për dinjitetin njerëzor.”* Qeveritë e botës riafirmuan angazhimin e tyre në vitin 1995 për *“të drejtat e barabarta dhe dinjitetin e lindur njerëzor të të gjithë grave e burrave”*, në Deklaratën e Platformën e Pekinit për Veprim.

Ndryshimet gjinore - Disa nga fushat ku janë të dukshme

Sociale - Diferencat që perceptohen për gratë dhe burrat në rolet sociale: burrat shihen si kryetarë të familjes, që kanë për detyrë të sigurojnë “bukën” e familjes; kurse gruaja shihet si ajo që bën punët e shtëpisë dhe kujdeset për fëmijët.

Politike - Diferencat në rrugët në të cilat gratë dhe burrat presupozohet të ndajnë fuqinë dhe autoritetin: burrat janë më shumë të përfshirë në politikat kombëtare dhe të niveleve të larta; gratë janë të përfshira në nivelet lokale në aktivitetet që lidhen me rolin e tyre si shtëpiake.

Ekonomike - Diferencat midis grave dhe burrave pranohen në ndryshimet e zhvillimit të karrierave dhe të kontrollit financiar, si dhe të burimeve të tjera produktive, marrjen e kredive dhe zotërimin e tokës ose të shtëpive.

Arsimi - Diferencat në mundësinë e arsimimit dhe pritjet e vajzave dhe të djemve: burimet familjare shkojnë më shumë për edukimin e djemve se sa të vajzave, vajzat kanë nevojë për nivele më të larta arsimimi për të hyrë në tregun e punës.

Feminizimi i dhunës

Fushat që përmendëm më lart përmbajnë shumë aspekte që theksojnë dukshëm ndryshimet gjinore. Një arenë e diskriminimeve në bazë të përkatësisë gjinore, që është pak më e ngushtë por shumë thelbësore, është familja.

Familja tradicionale zakonisht përkufizohet nga sociologët si një grup individësh i lidhur nga gjaku ose nëpërmjet martesës, që jeton bashkë, bashkëpunojnë ekonomikisht dhe ndajnë përgjegjësitë për të rritur fëmijët e përbashkët. Familja është gjithashtu një grupim privat individësh, marrëdhëniet dhe sjelljet e të cilëve janë të padukshme për të tjerët; një organizim social kompleks që konsiston në shumëllojshmëri rolesh dhe statusesh; dhe së fundmi marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të një familje janë më intime, më emocionale dhe më të

ndjeshme. Fatkeqësisht familja kthehet shpesh në një burim dhune për pjesëtarët e saj, sidomos kur këta pjesëtarë janë të gjinisë femërore.

Ky fakt sjell atë që e quajmë *'feminizim të dhunës në familje'* pasi viktimat më të shpeshta mbeten gratë dhe vajzat. Shkaqet që çojnë në feminizmin e dhunës në familje do t'i përmendim në vijim.

C. Qendra/Institucione që ofrojnë asistencë lidhur me dhunën në familje

RRJETI KUNDËR DHUNËS GJINORE DHE TRAFIKIMIT

1. Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim

Kontakt: Eglantina Gjermani

Adresa: Rr. "Abdyl Frashëri", Pall. 10/1, Ap.3,

Kutia Postare 2418, Tiranë

Tel: 04 22 55 514

Faks: 04 22 55 515

E-mail: qdi@gadc-al.org

Web: www.gadc-al.org

2. Qendra e Këshillimit për Gra e Vajza, Tiranë

Kontakt: Iris Luarasi

Adresa: Rr " Sami Frashëri", pranë shkollës "11 Janari", Shk.2, k.3

P.O. Box 2416/1, Tiranë

Tel: 04 22 33 408/9

E-mail: luarasi@gmail.com

3. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Kontakt: Aurela Anastasi

Adresa: Rr. "Vaso Pasha", P. 12, Shk 1, Ap 1

Tel. 04 2259 795

Faks: 04 2241 914

E-mail: avokatore@albmail.com

Web: www.qag-al.org

4. Shoqata "Refleksione"

Kontakt: Monika Kocaqi

Adresa: Rr. e Elbasanit, P. Fratari, Tërshana 2, kati i parë,

P.O.BOX 2412/1, Tiranë,

Tel/Fax. 04 23 40 433

E-mail: refleksione@icc-al.org

Web site: www.refleksione.org

Në Shkodër, Tel/Fax: (0224) 284 44

Në Pogradec, Tel/Fax: (0832) 221 15

5. Strehëza për Gratë dhe Vajzat

Kontakt: Edlira Haxhiymeri

Tel/Fax: 04 22 61 885

Tiranë

QENDRA TË TJERA QË OFROJNË ASISTENCË:

1. Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri

Kontakt: Altin Hazizaj

Adresa: Pallatet e Shallvareve, Vila mbrapa fushave të tenisit

P. O. Box 1738, Tiranë

Tel / Faks: ++ 355 4 22 422 64

E-mail: crca@crca.org.al

Web: www.crca.org.al

2. Qendra e Trajtitimit Multidisiplinar për Problemet e Keqtrajtimit të Fëmijëve

Kontakt: Ditika Shehi

Rr. "Pjetër Bogdani", P. Teuta, K. ¾, Tiranë

Tel: + 355 4 22 67 038

E-mail: d.shehi@yahoo.com

3. Shoqata "Për Gratë dhe Fëmijët"

Kontakt: Rajmonda Prifti

Adresa: Ish-Kombinati i Drurit "Misto Mame", Tiranë

Tel: 04 23 52 830

E-mail: mondaprifti@albmail.com

4. Shoqata "Në Dobi të Gruas Shqiptare"

Kontakt: Sevim Arbana

Adresa: Rr. "Naim Frashëri", Nr.6, Tiranë

Tel: 04 22 23 001 / 22 47 502

E-mail: sevim@icc-al.org; uaw@icc-al.org

Web site: www.uaw-al.org

5. Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës

Kontakt: Bajana Cevoli

L. "11 Janari", prapa gjykatës Durrës.

Tel: 052 223 815 / 052 234 600

E-mail: bceveli@yahoo.com

shoqatagrave@yahoo.com

qendraekeshillimit@yahoo.com

6. Forumi i Gruas, Elbasan

Kontakt: Shpresa Banja

Lagja "5 Maji", P. "Fetah Ekmekçiu", P. 450/1

Tel: 054 255 509

E-mail: forumi_gruaselbasan@yahoo.com

shpresa_banja@yahoo.com

7. Unë Gruaja – Pogradec

Kontakt: Afroviti Gusho

Adresa: Rr. "Rreshit Çollaku", Pogradec

Tel: 083 222 140, Faks: 083 225 104

E-mail: viti@adanet.com.al;

une_gruaja@yahoo.com

8. Qendra Psiko-Sociale "Vatra"

Kontakt: Vera Lesko

Rr. Vlorë Skelë, Lagj. "Isa Boletini"

Mbi Bankën Italo-Shqiptare

Kati 3, Vlorë

Tel/Faks: 033 224 078

E-mail: qvatra@icc-al.org

qvatra@abcom-al.com

9. Qendra Gruas "Hapa të Lehtë"

Kontakt: Alketa Kabashi

L. "3 Heronjtë", Rr. "Branko Kadia", Nr. 57, Shkodër

Tel: 0224 4022

E-mail: qendragruashk@yahoo.com

hapatelehte@gmail.com

Web: www.hapatelehte.org

10. "Gruaja tek Gruaja"

Kontakt: Majlinda Angoni

L. "M.Alimani", Rr. V.Shanto, P.718,

Tel: 02 441 154

E-mail: gruajatekgruaja@gmail.com

11. "Me Ju dhe për Ju Vajza", Fier

Kontakt: Violeta Sota

Lagjja "Thoma Pogaçe"

Tel: 034 22 884

12. "Forumi i Pavarur i Gruas" – Sarandë

Kontakt: Lumturi Xhani

Lagjja Nr. 1, Rr. "Onhezmin", Sarandë

Tel: 085 22 22 76

Faks: 085 22 49 34

E-mail: jonaojq@yahoo.com

Bibliografia

Amnesty International, Prill 2006. *'Albania: Violence against women in the family 'It's not her shame'*.

Aleanca Gjinore për Zhvillim, 2007. *'Çfarë duhet të dimë rreth dhunës në familje'*, Broshurë informative për të rinjtë.

Aleanca Gjinore për Zhvillim, Prill 2006. *Dhuna në familje 'Një paraqitje e situatës aktuale në Shqipëri'*, Tiranë.

Aleanca Gjinore për Zhvillim, Nëntor 2007. *'Vetëm ligjet nuk mund ta ndalojnë dhunën, kurse ne të gjithë, Po!'* Broshurë informative, Tiranë.

Anastasi, A. 2008, *'Parandalimi i dhunës në familje – faktor i domosdoshëm për arritjen e barazisë gjinore. Mbi ligjin 'Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare.'* Raport, Tiranë.

Anastasi, A., Bozo, A., Qyrku., dhe Bozo, E. 2008. *'Monitorimi i zbatimit të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, 'Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare'*, Qendra për Nisma ligjore qytetare, Tiranë

Bejleri, F. 2008. *'Dhuna në Familje e Raportuar në Gjykatë dhe Efektet Psikosociale tek Fëmijët.'* Universiteti i Tiranës, i pabotuar.

Bregu, M., Gjermani, E., Korrik 2003. *'Dhuna ndryshon atë që prek'*, Gazeta 'Koha Jonë'.

OSCE, 2007. *'Covering Domestic Violence'*, A guide for journalists and other media professionals.

OKB, 1993. Raport i OKB mbi Dhunën ndaj Grave.

ISHP, Prill 2005. *Studim i shëndetit riprodhues në Shqipëri*, Raporti Final, Tiranë

Ligji nr. 9669 datë 18.12.2006 *"Për Masa ndaj Dhunës në*

Marrëdhëniet Familjare”.

Gallagher, M. 2001. *“Gender Setting - New Agendas for Media Monitoring and Advocacy”*; Zed Books & WACC.

Griffin, E. 2005. *A first look at communication theory. Agenda Setting Theory of Maxwell McCombs and Donald Show*. McGrawHill.

Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta, 2008. *‘Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në familje 2007-2010’*, Tiranë.

Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta, 2008. *‘Studim i situatës së barazisë gjinore në Shqipëri’*, Tiranë.

Mëniku, L. 2007 *‘Analizë e ligjërimit në Media për problemet e trafikimit të femrave dhe të dhunës ndaj tyre’*, në *‘Të jesh grua ...Në Shqipëri, pas viteve 1990’*. Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë.

Neimans, A. 2002 *Gender mainstreaming in practice: a handbook*, UNDP, Regional Bureau for Europe and CIS, fq. 80-82.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2007. *‘Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje’*, Manual për viktimat dhe organizatat jofitimprurëse, Tiranë.

Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, 1993. 48/104.

Tamo, A. dhe Karaj, Th. Korrik 2005 *“Dhuna kundër Fëmijëve në Shqipëri”* Qendra e Zhvillimeve Humane, Tiranë, fq 16.

Testolin, G. 2001, *“Manual mbi mekanizmat institucional për nxitjen e barazisë gjinore dhe planet për veprim”* EG 7 Këshilli i Europës, fq. 9-10.

Zenelaga, B. 2008 *‘Gratë e dhunshme, viktimat të shumëfishta të dhunës’*, Studime Sociale 2008, Vëll. 2, Nr.1: 89-102

UNIFEM, 2003. *Making a Difference, Strategic Communications to End Violence against Women*. A Toolkit from the UNIFEM Strategic Communications Workshop Series.

Wood, Julia T. 2005. *Gendered Lives*, Thomson Wadsworth.

Women’s Media Watch, 1998. *‘Whose Perspective – a Guide to Gender Sensitive Analysis of the Media’*, Training Manual; Jamaica, 29.

Burime nga Interneti

1. 'Stop Violence against women, Guidelines for Developing a Training Program', http://www.stopvaw.org/Guidelines_for_Developing_a_Training_Program.html?SEC={5074C791-13DC-4EAB-993F-F350719CE970}&Type=B_BASIC, parë për herë të fundit në shtator 2008.
2. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare
<http://www.qag-al.org/default.htm>, parë për herë të fundit më 27 gusht 2008.
3. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare
http://www.qag-al.org/Raport_zbatimin_L.9669.pdf, parë për herë të fundit më 27 gusht 2008.
4. UNDP Albania
<http://www.undp.mdg.org.al>, parë për herë të fundit në tetor 2008.
5. WACC, *Taking sides - Mission Possible': A Gender and Media Advocacy Toolkit*, <http://www.peacewomen.org/un/ngoadvocacy/1325Tools>, parë për herë të fundit në shtator 2008.

